

- Udhëzues për  
vetërregullimin e  
mediave

Të gjitha pyetjet dhe përgjigjet

Organizata për Sigurim dhe  
Bashkëpunim në Evropë

Përfaqësuesi i  
**Lirisë së Medias**

Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias falënderon qeveritë e Francës, Gjermanisë dhe Irlandës për mbështetjen e tyre bujare për këtë botim.

Do të dëshironim gjithashtu të shprehim mirënjohje për Robert Pinker, Peter Stuber dhe anëtarët e AIPCE për kontributet e tyre shumë të vlefshme në këtë projekt.

Pikëpamjet e shprehura nga autorët në këtë botim janë pikëpamjet e tyre dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias.

Botuar nga Miklós Haraszti, Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias  
Redaktuar nga Adeline Hulin dhe Jon Smith

© 2008 Zyra e Përfaqësuesit për Lirinë e Medias Organizata  
për Sigurim dhe Bashkëpunim (OSBE) Wallnerstrasse 6  
A-1010 Vienë, Austri  
Tel.: +43-1 514 36 68 00  
Fax: +43-1 514 36 6802  
E-mail: pm-fom@osce.org  
<http://www.osce.org/fom>

Grafika: Phoenix Design Aid, Denmark

ISBN 3-9501995-7-2

# ■ Udhëzues për vetërregullimin e mediave

Të gjitha pyetjet dhe përgjigjet

Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias  
Miklós Haraszti

Vienë, 2008



# Përmbajtja

## 7 Miklós Haraszti Parathënie

### 9 I. Vlerat e vetërregullimit të medias

*Balancimi i të drejtave dhe përgjegjësisë*

*Nga Miklós Haraszti*

- 10 1. Natyra e vetërregullimit të medias
- 13 2. Vetërregullimi i medias kundrejt rregullimit të medias
- 18 3. Inkurajimi i respektit reciprok dhe mirëkuptimi kulturor

### 21 II. Krijimi i një kodi etike për gazetarinë

*Baza për vetërregullimin e medias*

*Nga Yavuz Baydar*

- 22 1. Rëndësia thelbësore e kodit të etikës për një gazetari të përgjegjshme
- 24 2. Larmia e kodeve të etikës
- 25 3. Veçantia e përmbajtjes në kodet e etikës
- 28 4. Krijimi i një kodi etike: roli i profesionistëve të medias
- 30 5. Krijimi i një kodi etike: roli i qeverisë dhe shoqërisë
- 31 6. Nevoja për rishikimin periodik dhe promovimin e kodeve të etikës

**33 III. Organet vetërregulluese**

*Masat për respektimin e kodit të etikës*

*Nga William Gore*

- 34 1. Një alternativë e besueshme ndaj procedurave gjyqësore
- 36 2. Forca e kompensimit moral
- 40 3. Nevoja e përcaktimit të afateve për ankesat
- 41 4. Të gjitha mediat mund të rregullohen nga organe vetërregulluese
- 43 5. Sfida më e madhe: të sigurohemi që publiku e di se mund të ankohet

**45 IV. Këshilli i shtypit**

*Prototipi i një organi vetërregullues*

*Nga Ognian Zlatev*

- 46 1. Funksioni thelbësor këshillit të shtypit
- 48 2. Këshillat e shtypit në zonën e OSBE-së
- 51 3. Pyetjet që duhen bërë përpara se të ngrihet një këshill shtypi
- 53 4. Struktura dhe rregullat e këshillit të shtypit
- 56 5. Anëtarët dhe anëtarët e bordit të këshillit të shtypit
- 60 6. Anëtarët e ngarkuar me trajtimin e ankesave
- 61 7. Financimi i këshillit të shtypit
- 64 8. Krijimi i këshillave të shtypit në demokracitë e reja

**67 V. Ombudsmeni**

*Vetërregullimi brenda një institucioni mediatik*

*Nga Véronique Maurus*

- 68 1. Evolucionin e ombudsmanit
- 71 2. Puna e ombudsmanit

- 74 3. Sanksionet e ombudsmanit
- 76 4. Krijimi i pozicionit të ombudsmanit
- 78 5. Përzgjedhja e ombudsmanit
- 80 6. Sfidat e pozicionit të ombudsmanit

## 85 VI. Shtojcë

### *Shembuj ankesash të zgjidhura nga organet vetërregulluese*

- 86 Rasti 1: Ankesë për cenimin e privacisë
- 87 Rasti 2: Ankesë për cenimin e privacisë
- 88 Rasti 3: Ankesë për pasaktësi
- 90 Rasti 4: Ankesë për pasaktësi në një faqe interneti
- 91 Rasti 5: Ankesë për mosmbrojtjen e personave vulnerabël
- 92 Rasti 6: Ankesë për mosmbrojtjen e personave vulnerabël
- 94 Rasti 7: Ankesë për diskriminim

## 95 VII. Biografi





# Parathënie

## Miklós Haraszti

Nisma për këtë *Udhëzues për vetërregullimin e mediave* qëndron në thelb të mandatit të zyrës sime për mbrojtjen dhe mbështetjen e lirisë së mediave në zonën e OSBE-së.

Zyra ime mbështet gazetarët të cilët duan të bashkojnë përpjekjet e tyre për të rritur standardet profesionale duke forcuar kështu pozicionin shoqëror të gazetarisë. Bashkëpunimi ndërmjet gazetarëve në fushën e etikës është gjithashtu një terren shumë i mirë ku ata mund të bashkëpunojnë për t'u kërkuar qeverive të drejtat e tyre legjitime.

Megjithatë, cilësia nuk duhet të jetë asnjëherë parakusht për liri. Vetëm një shtyp krejtësisht i lirë mund të jetë plotësisht i përgjegjshëm.

Unë e konsideroj vetërregullimin dhe promovimin e gazetarisë cilësore si garanci shtesë për lirinë e medias dhe madje edhe për fuqinë e saj. Nën këtë frymë, ky udhëzues ka për qëllim të ofrojë informacion për gazetarët, redaktorët, botuesit, studentët e mediave si dhe për zyrtarët e qeverisë.

I hartuar në formën e pyetjeve dhe përgjigjeve, ky udhëzues është mjaft praktik dhe i lehtë për t'u përdorur. Nuk ekziston një model universal që të jetë i gatshëm për t'u përdorur kudo. Për këtë arsye, ky botim nuk përqëndrohet në vende të veçanta por trajton një gamë të gjerë çështjesh praktike. Si funksionojnë mekanizmat ekzistues vetërregullues? Çfarë vështirësish hasin? Si krijohen dhe si përmirësohen këto mekanizma?

Në secilin kapitull vihet theksi në aspekte të veçanta të vetërregullimit të medias, ku përfshihet roli i kodit të etikës si dhe mekanizma të ndryshëm përgjegjshmërie siç janë

## PARATHËNIE

ombudsmanët apo këshillat e shtypit. Unë shpresoj që lexuesit të gjejnë zgjidhje të cilat mund t'ua përshtasin kushteve të vendeve të tyre.

Gjithashtu shpresoj që ky udhëzues të shërbejë si shtysë për zhvillime të mëtejshme në vetërregullimin e medias, të rrisë cilësinë e gazetarisë dhe kështu të ndihmojë në përgjithësi situatën e lirisë së medias në zonën e OSBE-së.

Më lejoni të shpreh mirënjohjen time ndaj qeverisë së Francës, Gjermanisë dhe Irlandës për mbështetjen bujare që kanë dhënë në krijimin e këtij botimi unik.

Kapitulli I

# Vlerat e vetërregullimit të medias

Balancimi i të drejtave dhe përgjegjësie

*Nga Miklós Haraszti*

Vetërregullimi i medias është një përpjekje e përbashkët nga profesionistët e medias për të hartuar udhëzime editoriale vullnetare dhe për t'ju përmbajtur këtyre udhëzimeve gjatë një procesi të mësuarit i cili do të jetë i hapur ndaj publikut. Duke vepruar në këtë mënyrë, media e pavarur i pranon përgjegjësitë e veta në lidhje me cilësinë e debatit publik në vend, duke ruajtur plotësisht autonominë e saj editoriale në formësimin e tij.

## 1. Natyra e vetërregullimit të medias

### *A ka të bëjë vetërregullimi me përmbajtjen politike?*

Kurrësesi. Vetërregullimi nuk është censurë dhe as autocensurë. Ai ka të bëjë me vendosjen e parimeve minimale për etikën, saktësinë, të drejtat personale e kështu me rradhë duke ruajtur njëkohësisht lirinë editoriale në raportimet dhe opinionet e shprehura.

### *A ka të bëjë vetërregullimi me një shtyp të pagabueshëm?*

Askush nuk është i përkryer. Përveç kësaj, kritikata e shprehura publikisht gjithmonë do të perceptohen si të pasakta nga ata të cilët analizohen. Vetërregullimi i vjen në ndihmë medias që ajo t'u përgjigjet ankesave legjitime dhe të korrigojë gabimet duke u hasur me to gjatë punës së saj.

### *Cilët janë aktorët?*

Vetërregullimi është një angazhim i profesionistëve të medias, të ndërgjegjshëm për cilësinë, për të ruajtur dialogun me publikun. Mekanizmi i ankimit krijohet për të trajtuar shqetësimet e justifikuar në mënyrë racionale dhe autonome.

Në këtë dialog do të përfshiheshin natyrisht vetëm ato kanale mediash, gazetarët, redaktorët dhe pronarët e të cilave kërkojnë të prodhojnë një shtyp të përgjegjshëm. Vetërregullimi mund të krijohet si në nivel industrie ashtu dhe në atë individual.

Jashtë fushës së medias, janë zakonisht institucionet politike dhe figurat publike burimi nga vijnë ankesat, pasi raportimi dhe komentimi i veprimtarive të tyre është një punë me rëndësi për mediat serioze. Partnerë po aq të interesuar mund të jenë edhe protagonistët e shoqërisë civile siç janë organizatat e biznesit, të punës, ato fetare dhe të minoriteteve, grupe interesi tradicionale dhe të sapokrijuar dhe patjetër edhe individë të caktuar nga publiku.

***Pse është i dobishëm vetërregullimi i medias për shtypin?***

Duke nxitur krijimin e standardeve, vetërregullimi ndihmon në ruajtjen e besueshmërisë së medias në publik. Kjo mirëpritet veçanërisht në demokracitë e reja, për shumicën e të cilave shtypi i pavarur është një koncept ende i ri. Vetërregullimi i medias ndihmon që publiku të krijojë bindjen se mediat e pavarura nuk janë të papërgjegjshme.

Vetërregullimi mbron në të njëjtën kohë të drejtën e gazetarëve për të qenë të pavarur dhe për t'u gjykuar në lidhje me gabimet e tyre profesionale jo nga ata që janë në pushtet, por nga kolegët e tyre.

Kur bëhet fjalë për korrëgjimin e gabimeve në fakte apo cenim të të drejtave personale nga shtypi, pranimi i gjykimit të organit vetërregullues pakëson presionin e sistemit gjyqësor për të gjykuar gazetarët.

***Pse është në dobi të publikut vetërregullimi i medias?***

Është mëse e natyrshme që konsumatorët e medias të kërkojnë garanci për vlerën e informacionit të gazetarit. Kodet e etikës japin udhëzime mbi standardet editoriale, ndërsa mekanizmat e ankimit ofrojnë një farë “sigurie për cilësinë”.

Ankesat e trajtuara nga organet vetërregulluese nuk kanë kosto në ndryshim nga proceset gjyqësore. Ky është një avantazh i konsiderueshëm për një qytetar të thjeshtë. Këtu përfitojnë edhe politikanët që paraqesin ankesa duke gjetur zgjidhje të shpejta të mosmarrëveshjeve si dhe duke parë që gabimet pranohen publikisht dhe vullnetarisht nga shtypi.

***Pse i shërben demokracisë vetërregullimi i medias?***

Demokracia nuk ka të bëjë vetëm me kundërshtitë. Demokraci do të thotë një kulturë e përbashkët debatimi në mënyrë të arsyeshme dhe të drejtë. Qeveritë, megjithëse mund të jenë të zgjedhura në mënyrë të lirë, janë pjesëmarrëse në garën politike dhe për këtë arsye nuk janë shumë të përshtatshme për të vendosur arsyen dhe drejtësinë. Përveç kësaj,

## VLERAT E VETËRREGULLIMIT TË MEDIAS

demokracia nuk është e përputhshme me kontrollin e shtetit ndaj shtypit.



Vetërregullimi i medias është një përpjekje për të vendosur një kulturë politike të demokracisë të pavarur nga forcat politike, dhe që përshpejton gjithashtu kalimin nga një shtyp i kontrolluar nga shteti në një shtyp që është pronë dhe kontrollohet nga shoqëria civile.

**Pesë arsye përse media duhet të vetërregullohet:**

1. Ruhet liria editoriale;
2. Minimizohet ndërhyrja e shtetit;
3. Inkurajohet cilësia e mediave;
4. Dëshmohet përgjegjshmëria e mediave;
5. U lejohet lexuesve akses në media.

## 2. Vetërregullimi i medias kundrejt rregullimit të saj

### *A janë të nevojshëm ligjet për mediat?*

Deri në një farë mase, po. Megjithatë shtypi mund ta kryejë rolin e tij shumë të rëndësishëm si kontrollues i qeverisë kur ka sa më pak kontroll nga shteti.

Në shoqëritë të cilat janë në rrugën drejt demokracisë, garancitë kushtetuese dhe ligjore janë të domosdoshme për t'i bërë të zbatueshme liritë e shtypit. Për shembull:

- Kushtetuta duhet ta ndalojë censurën dhe të mbrojë lirinë e shprehjes;
- Ligjet duhet të garantojnë akses të lirë në informacionin qeveritar dhe të mbrojnë gazetarët nga shtrëngimi për të treguar burimet konfidenciale të historive investigative;
- Rregulloret duhet të garantojnë administrimin e drejtë dhe transparent të biznesit të medias siç është regjistrimi, licensimi, deklarimi i pronësisë dhe taksimi.

Në demokraci, përjashtimet nga liria e shprehjes duhen përcaktuar në ligj. Për hir të një debati të pafrikë mbi çështjet publike, duhet të kriminalizohen vetëm pak lloje shkeljesh që kanë të bëjnë me lirinë e shprehjes. Këto përfshijnë fjalë apo imazhe të cilat me siguri apo me shumë gjasa do të vinin në rrezik sundimin e ligjit, qetësinë publike apo sigurinë e individëve, për shembull: nxitje për dhunë, thirrje për diskriminim apo përhapje e pornografisë së fëmijëve.

Shprehje të cilat “thjesht” shokojnë, shqetësojnë apo ofendojnë duhet të trajtohen nga gjykatat civile. Po kështu edhe për shprehjet që dhunojnë privacinë, fyejnë dinjitetin apo shkelin nderin – edhe nëse kryhen me dashje nga gazetarë të papërgjegjshëm e joprofesionistë.

***A mund të cenohen liritë e shtypit nga rregulloret e qeverisë?***

Kufizime ligjore të panevojshme që miratohen nga qeveritë e zgjedhura në mënyrë të lirë, mund të jenë po aq të padrejta për shtypin sa edhe arbitrariteti diktatorial në të shkuarën.

Kjo është veçanërisht e vërtetë kur kufizimet ligjore krijohen (apo keqpërdoren) me qëllimin e qartë për të eliminuar raportimin dhe opinionin e pavarur. Të tilla ligje të dëmshme për median mund të:

- Diskriminojnë mediat joshtetërore në favor të shtypit shtetëror ende ekzistues, për shembull në lidhje me administrimin e fushave të tilla si regjistrimi, taksimi, shtypja, abonimi dhe shpërndarja;
- Kontrollojnë padrejtësisht lëshimin e licensave të transmetimit;
- Kriminalizojnë pikëpamjet e pakicës apo të mos mirëpresin historitë investigative;
  - Të përdorin një qasje përzgjedhëse në zbatimin e dispozitave penale apo civile që mbrojnë të drejtat personale.

***A mund të cenohen padashje liritë e shtypit duke mbrojtur liri të tjera?***

Herë pas here rruga drej ndërrhyrjeve ligjore të panevojshme është e shtruar me qëllime të mira dhe shtyhet nga nevoja reale e publikut për standarde në gazetari. Shumë kufizime të panevojshme kanë për qëllim të rrisin etikën dhe cilësinë apo “balancën” e shtypit kundrejt vlerave të tjera të rëndësishme siç janë siguria e shtetit, qetësia sociale apo të drejtat personale. Duke u munduar të eliminojnë debate publike zemërake, shpeshherë qeveritë i tejkalojnë kufizimet legjitime të kriminalizimit të shprehjes dhe lejojnë ndjekjen e çdo shprehjeje jo tolerante apo diskriminuese, ose pikëpamje që fyejnë të tjerët. Ligje të tilla kanë

thjesht për qëllim që të imponojnë shijet e shumicës parlamentare në pushtet.

Për më tepër, në demokraci procesi i heqjes së kufizimeve të shprehjes, të cilat janë krijuar në kohë kur zbatoheshin standarde të tjera, mund të jetë i ngadaltë. Si shembull mund të përmendim:

- Kriminalizimi i përgojimit, shpifjes dhe fyerjes në vend të trajtimit të tyre në gjykata civile;
- Dënimi i “nxjerrjes së sekretit” nga civilët, ku përfshihen edhe gazetarët, në vend që ky krim të konsiderohet vetëm për ata që kanë detyrim zyrtar për të mbrojtur sekretet;
- Mbrojtje e veçantë e zyrtarëve të lartë nga përgojimi.

### *A mund ta bëjnë rregulloret e qeverisë më profesionale dhe më etike shtypin?*

Jo. Standardet e vërteta të etikës mund të krijohen vetëm nga profesionistë të pavarur të medias dhe zbatimi i tyre mund të jetë vetëm vullnetar. Pavarësisht miratimit të tyre me vullnet të mirë ose jo, përpjekjet për t'u imponuar gazetarëve standarde me ligj do të rezultojnë në kufizime arbitrare të të drejtave të tyre legjitime dhe kufizim të qarkullimit të lirë të informacionit në shoqëri.

Transmetuesit e shërbimit publik të paguar nga taksapaguesit janë të detyruar me ligj të raportojnë dhe komentojnë në mënyrë objektive, të drejtë dhe etike. Gjithësesi, edhe kërkesat e shërbimit publik duhet të formulohen dhe administrohen nga institucione të pavarura profesionale dhe kjo gjë do të funksionojë vetëm nëse politikanët nuk do të ndërhyjnë në punën editoriale.

### *Çfarë është më e rëndësishme: liria apo cilësia?*

Qeveria nuk duhet t'i trajtojë cilësinë dhe vetërregullimin si parakushte për të dhënë liri të plotë; përkundrazi, gazetaria etike mund të zhvillohet vetëm në një atmosferë ku liria është e garantuar. Vetëkufizimi i gazetarëve duhet të paraprihet dhe shoqërohet nga vetëkufizimi i qeverisë në trajtimin e medias.

***A mund të parashikohet në ligj vetërregullimi?***

Kjo do të ishte e dobishme në një aspekt: duke siguruar që gjykimet etike të një autoriteti vetërregullues të mos përdoren në gjykatë nga një profesionist i kritikuar i medias, shteti apo personi i dëmtuar.

***A mund të ndihmojë vetërregullimi në hartimin e ligjeve më të mira?***

Po, mundet, por jo duke ofruar vetëcensurim. Një media e vetërregulluar mund të luftojë më efektivisht për shfuqizimin e rregullave të panevojshme duke:

- Bindur publikun që mediat janë të ndërgjegjshme për nevojën e standardeve;
- Identifikuar dhe dënuar korrupsionin në media;
- Ofruar zgjidhje të ankesave në raste të justifikuar.

***Çfarë mund të bëjë qeveria për të inkurajuar vetërregullimin?***

Qeveria mund të inkurajojë vetërregullimin:

- Duke mospranuar pronësinë e shtetit në media;
- Duke siguruar liri të plotë të shtypit nga ndërhyrja e qeverisë;
- Duke e ruajtur median pluraliste nëpërmjet masave antimonopolizuese.

**Standardet ndërkombëtare ligjore për rregullimin e medias**

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNj) e kanë kthyer lirinë e shprehjes në të drejtë të çdo personi.

Qytetarët, të cilët besojnë se u janë kufizuar të drejtat e shprehjes mund t'i drejtohen Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) në Strasburg nëse nuk janë të kënaqur me mekanizmat ligjore në vendin e tyre.

Jurisprudenca e GjEDNj-së ka identifikuar një “test të trefishtë” për të matur korrektesinë e rregullimit të medias. Për të qenë në përputhje me lirinë e shprehjes, rregullimi duhet:

- Të jetë i përcaktuar në ligj;
- Të ndjekë një qëllim legjitim;
- Të jetë i nevojshëm në një shoqëri demokratike.

Kështu që nëse ka një metodë më pak shtrënguese për të arritur qëllimet legjitime rregullatore, metodat më shtrënguese nuk respektojnë standardet që mbrojnë pluralizmin dhe fjalën e lirë.

Qytetarët, të cilët besojnë se u janë kufizuar të drejtat e shprehjes mund t'i drejtohen gjithashtu edhe Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut në:  
<http://www.ohchr.org/english/bodies/hrc>

Shpjegimet për paraqitjen e një ankese mund të gjenden në:  
<http://www.ohchr.org/english/bodies/petitions/individual.htm#ccpr>

Gjatë 30 vjetëve që nga Marrëveshjet e Helsinkit, Shtetet Pjesëmarrëse të OSBE-së, kanë adoptuar një sërë angazhimesh detyruese për lirinë e mediave, të cilat mund të gjenden në:  
[www.osce.org/publications/rfm/2003/10/12253\\_108\\_en.pdf](http://www.osce.org/publications/rfm/2003/10/12253_108_en.pdf) (në anglisht)  
[www.osce.org/publications/rfm/2003/10/12253\\_108\\_ru.pdf](http://www.osce.org/publications/rfm/2003/10/12253_108_ru.pdf) (në rusisht)

Përfaqësuesi i OSBE-së për Liriën e Medias ([www.osce.org/](http://www.osce.org/) fom) inkurajon zbatimin e këtyre angazhimeve me anë të njoftimeve dhe rekomandimeve paprapake.

### 3. Nxitja e respektit reciprok dhe mirëkuptimit kulturor

#### *A mund të eliminohen konfliktet në media nga vetërregullimi?*

Jo. As ligjet e mira dhe as etika nuk do të kënaqin ndonjëherë plotësisht publikun për atë që bën media. Media e lirë – madje media cilësore – gjithmonë do të krijojë pakënaqësi tek të shënjuarit prej saj nga faktet e gjetura, opinionet dhe thjesht nga të qëniti pluraliste.

Vetërregullimi nuk është krijuar për të pakësuar nivelin e zhurmës në demokraci, por ka për qëllim ta bëjë atë një muzikë të pranueshme për publikun, të cilit – sidomos në demokracitë e reja – debatet e ashpra i duken të mërzitshme nëse duket se janë të pajustificuara. Së fundi, publiku dhe politikanët duhet të pranojnë që liria e fjalës, sipas Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, është “e drejta për të shokuar, shqetësuar dhe fyer”. Mediat kanë shumë interes që këtë liri ta bëjnë jo vetëm të tolerueshme por edhe të këndshme. Mënyra për ta arritur këtë është vetërregullimi i përgjegjshëm.

#### *A ekziston një krizë kulturore globale në lidhje me lirinë e shtypit?*

Në vitin 2006 pati protesta të gjera nga myslimanët kundër paraqitjes artistike shekullore me temë islamin, pas publikimit të disa karikaturave të cilat paraqisnin profetin Muhamet. Protestat konfirmuar ekzistencën e një tensioni të ri mbarëbotëror mbi shtypin e lirë i ngjashëm me atë që ekzistonte shekuj më parë në nivel kombëtar në fillimet e lirisë së shprehjes.

Këto karikatura u botuan fillimisht në gazetën daneze *Jyllands-Posten* në kuadër të mbrojtjes së lirisë kundër përfrikësimit. Më vonë u ribotuan në shumë media të tjera si informacion dhe si shenjë solidarizimi. Protestat muslimane, disa prej të cilave u bënë edhe të dhunshme, ishin të frymëzuara pjesërisht nga një zemërim i pastër për përmbajtjen e padenjë të karikaturave.

Gjatë krizës, e drejta tradicionale për të satirizuar edhe besimet e krijuara prej shumë kohësh u sulmua, e disa herë madje u bë realisht pré e “sulmeve të zjarrit”, gjë e cila provoi se në një botë ku kufijtë janë duke u shkrirë, mediat duhet të jenë shumë të ndjeshme ndaj kulturave në kontekstin global.

### ***A ka një rol mbarëbotëror për vetërregullimin?***

Respekti ndaj traditave duhet të jetë reciprok. Shumica e demonstruesve dhe disa qeveri kërkuan ndërhyrjen e shtetit në punën e mediave. Globaliteti i përplasjes kulturore nuk e ndryshon atë të vërtetë që qeveritë nuk duhet të ndërhyjnë në punën e gazetarisë së përgjegjshme. Mënyra e duhur për të nxitur profesionalizmin dhe përgjegjshmërinë globale është vetërregullimi. Botimet të cilat pa arsye fyejnë shtresa të ndryshme të shoqërisë duke treguar kështu një injorancë të papërgjegjshme të kontekstit global, duhet të trajtohen nga organet vetërregullatore të etikës për shtypin cilësor.

### ***Cfarë roli mund të luajë vetërregullimi i medias për të nxitur respektin reciprok dhe mirëkuptimin kulturor?***

Profesionistët e medias kanë një përgjegjësi të madhe për të ruajtur cilësinë e debatit në shoqëri dhe në botë. Në kohët kur ka tensione sociale apo fetare, është shumë e rëndësishme që media të mos i intensifikojë më tej këto tensione. Kodet e sjelljes duhet të mbledhin e të përmbledhin gjithë urtësinë e shtypit mbarë mbi këtë çështje.

Nuk është e nevojshme të testojmë lirinë e shprehjes për një respekt dhe kujdes më të madh. Rritja e ndërgjegjësimit mbi kulturat e ndryshme dhe një përgjigje më pozitive ndaj kërkesave globale duhet të plotësojë lirinë e shprehjes dhe jo t'a kufizojë atë. Në anën tjetër, një ndjeshmëri më e lartë nuk do të thotë që të mbytet kritika dhe debati ndërmjet kulturave. Jo vetëm që duhet mbrojtur pluralizmi, por edhe dinamizmi i tij pa të cilin nuk do të kishte progres dhe bota do të përbëhej nga civilizime të ndara me mure.





## Kapitulli 2

# Krijimi i një kodi etike për gazetarinë

Baza për vetërregullimin e medias

*Nga Yavuz Baydar*

Kodet e etikës përcaktojnë publikisht funksionet, të drejtat dhe detyrimet e gazetarëve duke u siguruar atyre parime udhëzuese për ta ushtruar sa më mirë profesionin. Emërtimi i këtyre kodeve varion: standardet e etikës, karta e etikës, kodi i sjelljes, kodi i praktikave, kodi i etikës, etj. Megjithatë, të gjitha kanë qëllim të ngjashëm që ka të bëjë me garantimin e autonomisë së profesionit dhe shërbimin ndaj interesit publik. Këtu përdoret termi “Kodi i Etikës” i cili është termi më i përdorur.

Në këtë kapitull jepet informacion praktik për krijimin e një kodi të tillë, shpjegohet përse çdo kod është thelbësor dhe unik, si duhet të përfshihen profesionistët e medias në krijimin dhe funksionimin e tij si dhe si duhet të promovohet dhe rishikohet ky kod.

# 1. Rëndësia thelbësore e kodit të etikës për një gazetari të përgjegjshme

## *Pse është i nevojshëm kodi?*

Në demokraci gazetarët gëzojnë të drejta dhe privilegje të mbrojtura, të cilat sigurojnë liri për të krijuar media të ndryshme, për të lëvizur në publik për të mbledhur fakte dhe pikëpamje, për të shpërndarë lajme dhe për të kërkuar përgjegjshmëri. Nga ana tjetër, edhe gazetarët duhet të jenë të përgjegjshëm. Ata duhet të veprojnë me ndërgjegje të pastër dhe me objektiva transparente.

Është e pashmangshme të ketë raste kur gazetarët duhet t'i vënë në provë kufijtë e lirisë së tyre në emër të mbrojtjes së interesit të publikut. Nëse gazetarët punojnë në përputhje me standarde të pranuar etike të sjelljes – bazuar në saktësi, drejtësi, pavarësi dhe përgjegjshmëri – ka pak të ngjarë që ata të shkelin ligjin. Kodi i etikës siguron mbizotërimin e lirisë së shtypit.

## *Për cilët gazetarë është kodi i etikës?*

Gazetaria e mirë është në interes të publikut. Ajo ofron lajme të sakta, të drejta e të balancuara, u jep zë atyre që nuk kanë dhe përmban llojshmërinë e pikëpamjeve që kërkon një histori e caktuar. Megjithëse është e lirë të përkrahë një parti të caktuar, ajo duhet të bëjë dallimin ndërmjet fakteve, komenteve dhe opinionëve – në ndryshim nga “gazetaria propogandistike”, “gazetaria misionare” e maskuar apo gazetaria tabloide, të cilat u shërbejnë çështjeve apo interesave të caktuara. Të gjithë gazetarët e mirë duhet t'i kushtojnë vëmendje të vazhdueshme kodit të etikës.

## *Kush përfiton nga kodi i etikës?*

Të gjithë. Për pronarët e mediave dhe botuesit, kodi siguron mbrojtje ndaj kritikës

## KRIJIMI I NJË KODI ETIKE PËR GAZETARINË

dhe veprimit ligjor; për gazetarët shërben si standard kundrejt të cilit mund të gjykohet puna e tyre; për publikun garanton që informacioni që ai merr është i drejtë, i saktë dhe i kontrolluar.

## 2. Larmia e kodeve të etikës

### *Përse kodet e etikës janë të ndryshëm në vende të ndryshme?*

Së pari, traditat e gazetarisë ndryshojnë nga një vend në tjetrin. Së dyti, disa vende veprojnë apo reagojnë më ngadalë se të tjerët në hartimin apo ndryshimin e udhëzimeve të tyre. Së treti dhe më me rëndësi, çdo shoqëri ka ndjeshmëritë e veta bazuar në natyrën e demokracisë dhe kodet e sjelljes sociale, kulturore, etnike e fetare. Këto ndjeshmëri shpesh reflektohen në përmbajtjen e lajmeve.

### *A mund të ekzistojnë kode të ndryshme në të njëjtin vend?*

Po. Gazetat, stacionet e radiove, kanalet televizive dhe faqet e internetit janë po aq të larmishme e dinamike sa edhe vetë gazetaria. Çdo lloj media mund të hartojë kodin e vet të etikës sipas nevojave.

### *A ia vlen të ekzistojë një kod i unifikuar në një vend?*

Jo domosdoshmërisht. Mund të jetë me vend të ekzistojë një kod i përbashkët ose një për shtypin dhe një tjetër për transmetimet. Një kod i miratuar në shkallë vendi mund të shërbejë si burimi kryesor për disa lloje kodesh. Praktika ndërkombëtare na tregon se më me rëndësi është angazhimi i të gjitha mediave për të pasur standardet e veta. E vërteta është që në raste të rralla një kod i përbashkët mund të krijojë edhe indiferencë apo neglizhencë.

### 3. Veçantia e përmbajtjes në kodet e etikës

#### *Si duhet të jetë një kod i mirë etike?*

Të jetë i shkruar në gjuhë të qartë; të jetë i kuptueshëm dhe i përmbledhur; të rishikohet dhe të përmirësohet rregullisht.

#### *A ka një model kodi i cili mund të përdoret në të gjithë botën?*

Jo. Mund të duket tërheqëse si ide, por vënia në praktikë do të ishte shumë e vështirë. Megjithatë ka disa udhëzime të cilat merren për bazë më shumë se të tjerat – të cilat janë ato të krijuara nga agjencitë ndërkombëtare të lajmeve apo gazetave cilësore siç është për shembull *Washington Post*. Mediat e lajmeve i njohin dhe ndikohen nga një sërë kodesh kombëtare, lokale e private, gjë që lejon nxitjen e standardeve të mira.

#### *Cilat janë parimet më të pranuar të etikës?*

Çështja e privacisë ka marrë shumë rëndësi vitet e fundit dhe kërkesat e kodeve në lidhje me shkeljen e privacisë janë bërë edhe më të rrepta. Vetërregullimi mbron edhe lirinë e shprehjes edhe shtetasit nga abuzimi me këtë liri, dhe këto të dyja shpeshherë bien në konflikt me njëra-tjetrën. Është e rëndësishme të jepet një përkufizim i qartë së çfarë konsiderohet interes publik. Në një kod mund të përcaktohet se çfarë është privacia dhe vendet private në bazë të të cilave njerëzit mund të ankohen për ndërhyrjen e shtypit në jetët e tyre private.

#### *A duhet të trajtojë kodi çështje të shijeve dhe etiketës së të shprehurit?*

Perceptimet e shijeve dhe etiketës variojnë nga një media në tjetrën dhe janë në ndryshim të vazhdueshëm sëbashku me ndryshimin e shoqërive. Pjesa më e madhe e gazetave cilësore kanë rregulla të forta mbi shijet dhe etiketën,

dhe të gjithë burimet e lajmeve duhet të përpiqen që t'i përcaktojnë këto koncepte duke i përditësuar për të pasqyruar ndryshimet në opinionin publik. Nëse për disa shtresa të audiencës lajmet dhe komentet përmbajnë diçka fyese, një situatë e tillë ka një efekt negativ mbi besueshmërinë e medias. Gazetat duhet të shohin përtej audiencës së tyre të rregullt, në mënyrë që të evitojnë fyrye të paqëllimta ndaj lexuesve rastësorë.

### *Cilat duhet të jenë rregullat e etikës në raportimin e terrorizmit?*

Aktet e terrorizmit duhet të raportohen saktë dhe me përgjegjshmëri. Duhet pasur një kujdes i veçantë me formulimin në të cilin duhet të shmangen lëvdatat për aktet e dhunshme dhe termat të cilat përmbajnë gjykime emocionale apo vlerësuese. Termi “terrorizëm” interpretohet në mënyra të ndryshme e ndonjëherë të kundërta. Siç e shpreh edhe BBC-ja shumë qartë: “Vetë fjala ‘terrorist’ mund të jetë më shumë një barrierë sesa ndihmesë në të kuptuar. Gazetarët duhet të mundohen që ta shmangin përdorimin e termit pa cituar burimin e informacionit. Ata duhet t'i lënë të tjerët të karakterizojnë ndërkohë që ata vetë raportojnë faktet”.

Përshkrimet e hollësishme të ndodhive duke mënjanuar përdorimin e termave të tillë si “luftëtarët e Irisë” apo “terroristët”, e rrisin besueshmërinë nga audienca. Qëllimi i gazetareve mbetet po ai si në raportimin e çfarëdolloj historie: t'i lënë lexuesit që të bëjnë gjykimet e veta.

### *Cilat duhet të jenë rregullat e etikës në shoqëritë shumëkulturore?*

Kodet e etikës duhet të përfshijnë udhëzime që trajtojnë shprehimisht çështjet e minoritetit. Shembulli i Komisionit të Britanisë së Madhe për Ankesat ndaj

## KRIJIMI I NJË KODI ETIKE PËR GAZETARINË

Shtypit tregon se një gjë e tillë mund të bëhet. Kodi i tij editorial i praktikës përmban një klauzolë të veçantë kundër diskriminimit: “Shtypi duhet të evitojë paragjykimet apo referencat përkeqësuese në lidhje me racën, ngjyrën, besimin, orientimin seksual apo paaftësinë ose sëmundjet fizike dhe mendore të një individi. Duhet mënjanuar hollësitë për racën, ngjyrën, orientimin seksual, paaftësinë ose sëmundjet fizike dhe mendore të një individi, përveç rasteve kur këto janë vërtetë të lidhura dhe më vlerë për historinë.”



Kjo do të thotë për shembull që një gazetar i cili raporton një krim nuk duhet të përmendë origjinën raciale apo etnike të një të dyshuari me përjashtim të rasteve kur policia ka dhënë një përshkrim të një individi të kërkuar (për shembull “ mashkull, i bardhë apo femër me tipare aziatike”). Ky parim ndiqet shumë në Mbretërinë e Bashkuar dhe Komisioni i Ankesave ndaj Shtypit i ka kritikuar ashpër gazetatat të cilat kanë shkelur kodin në botimin e rasteve të sulmeve brutale ndaj imigrantëve.

#### **Udhëzimet etike të BBC-së mbulojnë:**

1. Saktësinë
2. Paanshmërinë dhe larminë e opinionve
3. Drejtësinë, kontribuesit dhe pëlqimin
4. Privacinë dhe interesin publik
5. Krimin dhe sjelljet anti shoqërore
6. Dëmtimet dhe shkeljet
7. Fëmijët
8. Politikën dhe politikat publike
9. Luftën, terrorin dhe emergjencat
10. Besimin
11. Integritetin dhe pavarësinë editoriale
12. Marrëdhëniet e jashtëme
13. Ndërveprimin dhe audiencën
14. Ligjin
15. Përgjegjshmërinë

Burimi: [www.bbc.co.uk/guidelines/editorialguidelines](http://www.bbc.co.uk/guidelines/editorialguidelines)

## 4. Krijimi i një kodi etike: roli i profesionistëve të medias

### *Kush e ka përgjegjësinë e hartimit të kodit?*

Gazetarët. Cilësia e një gazete përcaktohet nga disa komponentë – saktësia, drejtësia, balanca, ndershmëria e kështu me radhë — të cilat nënkuptojnë përgjegjësi për krijimin e një kodi etike në duart e profesionistëve të cilët kontribuojnë në bërjen e tij.

### *A duhen konsultuar grupet e industrisë/pronarët e mediave?*

Jo domosdoshmërisht. Nëse pronarët e medias janë gazetarë aktivë në media, ata duhen konsultuar. Në disa raste të rralla, kodi mund të duhet të miratohet nga industria. Gjithësesi, përgjegjësia përfundimtare u mbetet redaktorëve.

### *Si binden gazetarët dhe redaktorët për të hartuar një kod?*

Reporterët dhe redaktorët duhet të vendosin një standard cilësie për besueshmërinë e tyre. Kjo bëhet gjithë e më e vështirë pasi edhe publiku bëhet gjithë e më i sofistikuar dhe i mësuar me komunikimin dhe ndërveprimin nëpërmjet internetit me kompanitë e lajmeve dhe me përgjigje të shpejta e të besueshme. Në shumë shoqëri, niveli i arsimimit dhe “alfabetizimit mbi lajmet” është në rritje të vullshme dhe publiku është më i ndërgjegjshëm për anësitë dhe shtrëmbërimet e lajmeve. Zbatimi i një kodi etike i ndihmon organizatat që të përballen me këto vështirësi dhe të ruajnë një marrëdhënie të ndershme me lexuesit e tyre. Në një perspektivë afatgjatë, kodi i etikës bëhet një mjet i fuqishëm tregtar dhe një mjet konkurrues.

***Si binden botuesit/pronarët e medias për të respektuar kodin?***

Në këtë pikë janë të zbatueshme të gjitha argumentet e mësipërme. Përveç këtyre, respektimi i një kodi etike e redukton ndjeshëm rrezikun e ndërhyrjeve ligjore dhe veprimeve të kushtueshme ligjore. Nëse nuk do të kishte një kod etike, alternativa e mbetur do të ishte salla e gjyqit.

***Si binden gazetarët për të zbatuar kodin?***

Duke rritur ndërgjegjësimin: Drejtuesit duhet të marrin masa që çështjet etike të diskutohen rregullisht nga stafi – jo vetëm kur del një rast caktuar. Stafi mund të instruktohet së brendshmi mbi standardet nga redaktorë të respektuar dhe me përvojë. Sa më shumë të mbahen gjallë e të rrihen këto çështje, aq më shumë përkushtim do të ketë.

Duke ekzaminuar përmbajtjen: Shumë gazeta caktojnë një ombudsman të pavarur lajmesh për të ekzaminuar përmbajtjen, gjë që bëhet për t'iu përgjigjur ankesave të lexuesve si dhe si një nismë e pavarur. Vlerësimet e ombudsmanit, të bazuara në kodin e etikës, publikohen ose transmetohen. Kjo gjë e mban gjallë ndërgjegjësimin për ekzistencën e kodit dhe krijon një kulturë inistitucionale në të cilën gazetarët e shohin sjelljen etike si normë.

Duke marrë masa lavdëruese dhe kritikuese: Institucionet e përkushtura të lajmeve duhet t'i lavdërojnë rregullisht dhe publikisht sjelljet etike dhe të kritikojnë shkeljet.

***Cfarë ndodh nëse gazetarët nuk janë dakord me disa rregulla të kodit?***

Gazetarët duhet të zbatojnë standardet themelore të vendosura nga institucioni në të cilin punojnë. Duke pranuar të punojnë për një institucion të caktuar, kuptohet që ata janë dakord me kodin e etikës së këtij

## KRIJIMI I NJË KODI ETIKE PËR GAZETARINË

institucioni, busullën e cila nuk lejon devijimet nga standardet e rëna dakord për një gazetari të mirë.

Disa media parashikojnë një klauzolë të veçantë në kontratat e punës që ka të bëjë me respektimin e kodit të etikës. Disa të tjerë preferojnë një qasje më pak detyruese të shoqëruar me një përkushtim të patundur ndaj etikës.

## 5. Krijimi i një kodi etike: roli i qeverisë dhe shoqërisë

### *Cili duhet të jetë roli i qeverisë në hartimin dhe adoptimin e kodit?*

Qeveria nuk duhet të jetë një pjesëmarrës aktiv. Profesionistët e medias janë përgjegjësit e vetëm për hartimin e kodit të etikës. Ndërhyrja zyrtare do ta vinte në rrezik pavarësinë e një projekti të tillë.

### *Cili duhet të jetë roli i shoqërisë në formulimin e kodit?*

Këshillues. Hartuesit e kodit duhet të kërkojnë këshillim ligjor, duhet t'u referohen kodeve të mëparshëm dhe të shfletojnë literaturë vendase dhe ndërkombëtare. Ata duhet të marrin parasysh pikëpamjet e publikut dhe opinionet e informuara. Pikëpamjet e profesionistëve të tjerë – ligjvënësit, juristët, akademikët – duhen mirëpritur gjithashtu.

Organizatata joqeveritare, sidomos ato që përfaqësojnë interesa të cilat ka të ngjarë të përbëjnë çështje etike kur preken nga mediat, do kenë pikëpamjet e tyre të cilat meritojnë të respektohen dhe duhen marrë parasysh. Gjithësesi nuk duhet të harrojmë se këta profesionistë dhe organizata kanë interesat e tyre specifike dhe sugjerimet e tyre duhen parë me një farë distance dhe rezervimi.

Më shumë përparësi u duhet dhënë pikëpamjeve të gazetarëve, të cilët duhet të garantojnë pavarësinë e tyre editoriale me hartimin e një kodi etike me po aq xhelozsi sa edhe për çdo botim tjetër.

## 6. Nevoja për rishikimin periodik dhe promovimin e kodeve të etikës

### *Përse duhen rishikuar kodet?*

Shoqëritë ndryshojnë në mënyrë të vazhdueshme, gjë e cila ndikon mënyrën se si mblihen, vlerësohen dhe shpërndahen lajmet. Mënyra e punës së gazetarëve ndikohet nga dilemat e reja, nga studimet më të fundit dhe mendësitë në një shoqëri. Për shembull kohët e fundit tregohet se mënyra se si raportohen vetëvrasjet mund të shtyjë individët të imitojnë të tilla sjellje dëmtuese. Gazetarët janë nën presionin për të mos nxitur veprime të tilla imituese dhe për këtë duhet të bëjnë ndryshimet përkatëse në kodet e tyre të etikës.

### *Kur duhen ndryshuar kodet?*

Shenja paralajmëruese vjen atëherë kur një kod nuk duket se arrin t'i përgjigjet dilemave që dalin gjatë përgatitjes së lajmeve. Kur gazetarët janë dakord se ka gabime, mangësi apo boshllëqe të konsiderueshme në një kod etike, atëherë ka ardhur koha që ky kod të rishikohet dhe të ndryshohet.

### *Kush është përgjegjës për rishikimin?*

Nëse është një kod etike i një organizate gazetarie – një federatë, shoqatë apo bashkësi – mund të ketë një komision me gazetarë profesionistë të caktuar nga organizata. Nëse është kodi i një media të caktuar, mund të jetë një grup gazetarësh me përvojë të caktuar nga kryeredaktori, në të cilin mund të marrë pjesë edhe vetë kryeredaktori.

### *Si mund të ndërjegjësohen gazetarët për ekzistencën e kodit?*

Nëse kodi i etikës lëshohet nga një organizatë gazetarie, atëherë është detyra e kësaj organizate që të rrisë ndërjegjësimin me anë të

njoftimeve nëpër botime dhe faqe interneti, nëpërmjet diskutimeve, konferencave, debateve radiofonike dhe televizive.

Nëse kodi lëshohet nga një media e caktuar, drejtuesit e saj duhet të njoftojnë stafin e tyre nëpërmjet komunikimit të brendshëm dhe diskutimeve dhe të marrin masa e të nxisin punonjësit që të kenë mundësi t'i referohen këtij kodi sa herë është e nevojshme.

Çështjet etike duhen trajtuar në arsimin universitar me anë të kurseve trajnuese profesionale.

### ***A duhet ndërgjegjësuar publiku për ekzistencën e kodit?***

Publiku si lexues, dëgjues, shikues dhe përdorues i internetit, duhet vënë në dijeni se mediat kanë kode etike dhe se ato i zbatojnë këto kode. Është një aspekt shumë i rëndësishëm për të ruajtur besueshmërinë, të kuptuarit dhe besimin.

Kodet duhen bërë të njohur në lajmet dhe komentet e vetë mediave dhe duhet të jenë të disponueshme në faqet e internetit të këtyre mediave. Shkeljet e kodeve dhe gjykimet e bëra në bazë të tyre, duhen raportuar sa më shpejt të jetë e mundur. Raportet e ombudsmanit, nëse media e ka një të tillë, ai duhet t'i referohen kodit sa herë që është e nevojshme.





## Kapitulli 3

# Organet vetërregulluese

## Masat për respektimin e kodit të etikës

*Nga William Gore*

Hartimi i një kodi etike është vetëm hapi i parë drejt një vetërregullimi efektiv të medias. Është shumë e rëndësishme që të krijohet një institucion për ta mbikëqyrur dhe për të marrë masa kundër atyre që e shkelin.

Këto insitucione mund të jenë të formave të ndryshme. Format më kryesore janë ombudsmani dhe këshillat vetërregullues të shtypit, të cilët përshkruhen në kapitujt në vijim.

Në këtë kapitull krahasohen avantazhet e organeve vetërregulluese me procedurat e gjyqit; vlerësohet fuqia e sanksioneve morale; bëhet një analizë se sa mund t'i përshtaten organet vetërregulluese të gjitha llojeve të mediave si dhe shqyrtohen aspekte të ndryshme të trajtimit të ankesave siç janë afatet, ndërgjegjësimi mbi të drejtën për t'u ankuar dhe proaktiviteti.

# 1. Një alternativë e besueshme ndaj procedurave gjyqësore

## *Përse është i vlefshëm një organ vetërregullues?*

Organet vetërregullues përcaktojnë kufijtë ndërmjet të drejtave legjitime të një shtypi të lirë dhe të drejtave legjitime të njerëzve të cilët tërheqin vëmendjen e medias. Në përgjithësi këtë e bëjnë duke shqyrtuar ankesat kundrejt një kodi etike të rënë dakord dhe duke gjykuar nëse janë shkelur apo jo rregullat e këtij kodi. Kështu, organet vetërregulluese japin udhëzime për gazetarët dhe publikun se cilat praktika janë të pranueshme dhe cilat janë standardet e pritshme nga një media. Trajtimi i ankesave mund të çojë në rritjen e standardeve profesionale.

## *Përse duhet krijuar një organ për të trajtuar ankesat ndërkohë që gjykatat e japin këtë shërbim?*

Megjithëse gjykatat duhet të kenë rolin e ruajtjes së ligjit, në demokraci shtypi duhet të jetë i lirë nga ndërhyrja e tepërt politike dhe gjyqësore. Është më mirë që shtypi të vetërregullohet apo t'ia delegojë rregullimin një organi të pavarur. Lexuesit kanë më tepër besim në ato gazeta të cilat janë të gatshme të pranojnë përgjegjësi për veprimet e tyre.

Në këtë aspekt ka edhe përfitime praktike. Kostot e ankuesve për shembull, janë të jenë më të ulta se sa kur përfshihen avokatët; koha që duhet për të shqyrtuar ankesat është më e shkurtër; ndryshimet në rregullore bëhen më shpejt dhe procesi është më pak konfrontues se sa kur çështja shkon në sallën e gjyqit.

### ***A mund të depozitohen ankesat edhe në gjykatë edhe në organin vetërregullues në të njëjtën kohë?***

Është më e preferueshme që jo. Organet vetërregulluese punojnë më mirë kur të dyja palët e përfshira në një mosmarrëveshje pajtohen nëpërmjet ndërmjetësimit dhe çështjet zgjidhen me korigjime, falje, etj.

Kjo gjë është më e vështirë për t'u arritur nëse në të njëjtën kohë është duke u zhvilluar edhe një proces ligjor. Mediat mund të jenë më pak të prirura për të bashkëpunuar me organin vetërregullues nëse ato kanë frikë se përpjekjet e tyre për t'i zgjidhur çështjet në mënyrë miqësore, mund të përdoren kundër tyre në gjykatë.

## 2. Forca e kompensimit moral

### *Cfarë sanksionesh duhet të përdoren nga një organ vetërregullues?*

Sanksioni më i madh është “grykimi kritik” të cilin media ofenduese, e cila ka hyrë vullnetarisht në sistem, është e detyruar ta botojë. Në këtë mënyrë, redaktorët detyrohen t’i pranojnë stafit, kolegëve dhe lexuesve të tyre që nuk kanë gjykuar drejt dhe nuk kanë vepruar sipas standardeve të cilat kanë rënë dakord t’i ndjekin.

### *A kanë efekt sanksionet morale?*

Komisioni i Ankesave ndaj Shtypit në Britaninë e Madhe ka vërejtur se pjesa më e madhe e ankesave janë zgjidhur në mënyrë miqësore. Kjo ndodh sepse redaktorët i evitojnë ankesat drejtuar kundër tyre sa herë që mundën – shenjë kjo që tregon se sa efektiv mund të jetë kërcënimi i një grykimi kritik. Pra, forca e sanksioneve morale nuk duhet nënvlerësuar.

### *A nuk do të ishte gjobitja e gazetave një ndëshkim më i mirë?*

Rregullimi vullnetar ka më shumë efekt kur sanksionet nuk parashikojnë penalitete financiare. Çdo sistem që parashikon gjoba bëhet më legalist dhe konfrontues ku hyjnë në lojë avokatët mbi masën e penaltetit që duhet vendosur. Kjo gjë do dobësonte gjithçka që e bën organin vetërregullues praktik dhe të dobishëm.

Ka prova që tregojnë se penalizimet financiare nuk janë ndëshkime efektive për gazetatat sepse fitimi nga rritja e shitjeve të tyre nga një histori që prek privacinë e dikujt mund ta tejkalojë gjobën për këtë shkelje. Për më tepër, efekti i gjobave do të do të variojë gjërësisht dhe padrejtësisht në varësi të gjendjes financiare të gazetës për të cilën bëhet fjalë.

Në çdo rast, organi vetërregullues do të kishte shumë vështirësi në vënien e gjobave apo kompensimeve dhe do të mund ta bënte këtë gjë vetëm po të kishte një bazë ligjore – gjë e cila patjetër do të ishte në konflikt me nocionin e vetërregullimit të sistemit.

### ***A duhet të ketë kompetenca një organ vetërregullues për të dhënë kompensime?***

Në përgjithësi palës ankuese që ka të drejtë nuk i jepet kompensim monetar për të njëjtat arsye që nuk vendosen edhe gjobat.

### ***A duhet të kenë organet vetërregulluese autoritetin për të pezulluar gazetarët apo gazetat?***

Kjo gjë mund të paraqesë probleme serioze. Së pari, ndalimi i qarkullimit të informacionit nga media tek publiku fyen vetë parimin e përgjithshëm të lirisë së shtypit. Pezullimi i botimeve ndëshkon publikun po aq sa edhe gazetën. Së dyti, mund të duket e padrejtë që të ndëshkohen gazetarë të caktuar në një sistem ku janë redaktorët ata që mbajnë përgjegjësi për atë që botohet.

### ***A duhet garantuar me ligj e drejta e përgjigjes?***

Është e panevojshme dhe jopraktike. Nuk është e përshtatshme që ta vendosin gjyqtarët se kur duhet dhënë kjo e drejtë. Është shumë më mirë që këtë ta vendosë një organ vetërregullues.

### ***A duhet të sigurojë organi vetërregullues të drejtën automatike për përgjigje?***

Komisioni i Ankesave ndaj Shtypit në Britaninë e Madhe, nuk mendon se individët duhet të kenë automatikisht të drejtë tu përgjigjen pretendimeve ndaj tyre. Në vend të kësaj, komisioni shprehet se mundësia për t'iu përgjigjur pasaktësive duhet dhënë kur “kërkohet për arsye të drejta”. Organe të tjera vetërregulluese shprehen se mundësia

për t'iu përgjigjur kritikave duhet dhënë sa herë një individ apo organizatë vihet në shënjestër. Megjithatë, këtu ekziston rreziku se kjo gjë mund të pengojë lirinë e shtypit për të analizuar dhe për të qenë kritik dhe kjo është arsyeja përse çështja e “të drejtës për përgjigje” është delikate.

### **E drejta për tu përgjigjur, përcaktuar nga Komisioni për Ankesat ndaj Shtypit në Britaninë e Madhe**

Dispozita 1 e kodit të praktikës së Komisionit për Ankesat ndaj Shtypit (Saktësia), thotë se: “shtypi duhet të tregojë kujdes e të mos botojë informacion të pasaktë, mashtrues apo të shtrëmbëruar” dhe më pas përcakton se “sapo të vërehet një pasaktësi e konsiderueshme, deklaratë mashtruese apo shtrëmbërim duhet bërë korrigjimi i menjëhershëm duke i dhënë rëndësinë e duhur ...”

Dispozita 2 e kodit (mundësia për përgjigje) përcakton: “Mundësia për t’iu përgjigjur pasaktësive duhet dhënë kur kërkohet për arsye të drejta.” Vendimi nëse një kërkesë për mundësi përgjigjeje është “e drejtë” merret nga Komisioni për Ankesat ndaj Shtypit.

### ***A duhet të kenë mundësi ankuesit të apelojnë kundër vendimeve të organit vetërregullues?***

Duhet të ekzistojnë mekanizma që ankuesit të apelojnë nëse dalin fakte të reja që provojnë se ankesa e tyre është keqkuptuar. Apelimet mund të lejohen edhe me arsyen se organi nuk i ka ndjekur siç duhet procedurat e veta. Në Britaninë e Madhe, ankesat për keqadministrimin e ankesave nga ana e Komisionit të Ankesave ndaj Shtypit i drejtohen një ombudsmeni, Komisionerit të Statutit i cili është i emëruar nga ky komision por vepron i pavarur nga ai. Komisioneri mund t’i shqyrtojë ankesat vetëm nga ana procedurale por jo në lidhje me përmbajtjen.



Në Britaninë e Madhe, vendimet e marra nga “autoritetet publike” mund të apelojnë në gjykatë me anë të një procedure që quhet “shqyrtim gjyqësor”. Nuk është përcaktuar asnjëherë zyrtarisht nëse Komisioni i Ankesave ndaj Shtypit në Britaninë e Madhe është apo jo një “autoritet publik”,

por ky komision nuk e ka kundërshtuar mundësinë që vendimet e tij janë, në teori, të hapura ndaj një shqyrtimi të tillë. Gjatë 15 viteve të ekzistencës së tij, vetëm tri çështje janë shqyrtuar nga gjykata. Në njërin rast gjyqtari doli në përfundimin që komisioni ishte organi i duhur për të vendosur nëse ishte shkelur Kodi i Praktikës së industrisë së gazetave dhe vendimi i gjykatës ishte se komisioni i kishte ndjekur saktë procedurat. Si rezultat, gjyqtarët nuk shqyrtuan përmbajtjen e vendimeve të komisionit.

Prania e procedurave të ngjashme në vende të tjera varet nga statusi i organit vetërregullues dhe natura e strukturave ligjore të këtyre vendeve.

### 3. Nevoja e përcaktimit të afateve për ankesat

#### *A duhen vendosur afate për ankesat?*

Pjesa më e madhe e organeve vetërregulluese vendosin afate brenda të cilave duhet të depozitohen ankesat. Afatet variojnë nga rreth një muaj deri në më shumë se gjashtë muaj nga botimi apo përfundimi i korrespondencës ndërmjet ankuesit dhe redaktorit (me kusht që ankesa të jetë bërë menjëherë pas botimit).

#### *Përse vendosen afate?*

Ankesat hetohet me më shumë efektivitet kur rrethanat janë ende të freskëta në mendjen e palëve të përfshira dhe ndërkohë që çështja e trajtuar në artikull apo e transmetuar është ende aktuale. Provat mbështetëse - siç janë shënimet e reporterit – ka më pak të ngjarë të jenë të disponueshme nëse bëhet fjalë për diçka që ka ndodhur shumë kohë më përpara depozitimit të ankesës. Për më tepër, mjetet korrigjuese të organit vetërregullues – faljet, korrigjimet apo gjykimet kritike për shembull – kanë më shumë kuptim nëse bëhen menjëherë.

#### *A janë të zbatueshëm afatet kur artikujt shkarkohen nga interneti?*

Disa organe vetërregulluese e konsiderojnë shkarkimin e një artikulli si një botim të freskët. Për këtë arsye, materialet që janë lehtësisht të disponueshme në faqen e internetit të një gazete në përgjithësi mund të jenë subjekt ankimi edhe nëse artikulli nuk është botuar fillimisht brenda afatit përkatës.

## 4. Të gjitha mediat mund të rregullohen nga organe vetërregulluese

### *Për cilat media mund të shërbejë vetërregullimi?*

Organet vetërregulluese mund të përdoren mjaft mirë për të mbikëqyrur të gjitha llojet e mediave. Gjithsesi, ato mund të jenë më të përshtatshme për të trajtuar çështje të redaktimit se sa llojin e çështjeve teknike që mund të dalin në lidhje me transmetimet. Mediat transmetuese mund të kërkojnë rregullore më specifike, pasi ato janë të licencuara ndryshe nga mediat e shtypit. Në të vërtetë, procesi i licencimit kërkon mbikëqyrje të posaçme.

### *Cilat janë vështirësitë për vetërregullimin e mediave në Internet?*

Rregullimi i internetit mund të jetë veçanërisht i vështirë pasi bota *online* është vërtetë globale. Duke qenë se faqet e internetit mund të barten në shtete mjaft larg nga audienca e synuar, linden pikëpyetje mbi shtrirjen e cilësdo organizatë rregulluese që ka për detyrë të administrojë kodet mbikëqyrëse.

Si rrjedhojë, rregullimi i Internetit arrihet më mirë përmes rregullimit të fushave të caktuara. Për shembull, organet vetërregulluese që në të kaluarën kanë mbikëqyrur median e shkruar tani mund të rregullojnë edhe faqet e internetit që operohen nga gazeta dhe revista – edhe nëse versioni *online* është i ndryshëm nga botimet në letër. Këto faqe mund të përmbajnë materiale audiovizuale me të cilat organi vetërregullues mund të mos jetë marrë tradicionalisht dhe duhet të vendosë nëse duhet të pranojë ankesa për këto materiale njësoj sikur të ishin një artikull apo një fotografi të botuara në një gazetë apo revistë.

Mekanizmat vetërregulluese mund të jenë tejet të përshtatshme për t'u marrë me përparimet me hapa të shpejtë të teknologjisë pasi ato priren të jenë qenësish më të përkulshme se instrumentet statutorë.

### ***A mund të mbikëqyrin organet vetërregulluese përmbajtjen e gjeneruar nga përdoruesit në Internet?***

Materiali i gjeneruar nga përdoruesit nuk është specifik vetëm për mediat në internet. Ai gjithashtu shfaqet në gazeta, në televizionin tradicional dhe në transmetimet në radio. Në të gjitha rastet, organet vetërregulluese mund të përshtaten për të trajtuar një material të tillë. Çelësi është që të sigurohemi që çdo rast të trajtohet në bazë të tipareve të veta dhe që vëmendje e veçantë t'i kushtohet gradës së mbikëqyrjes redaktuese të materialit. Filmimet me video të gjeneruara nga përdoruesit dhe të ngarkuara në një faqe interneti gazete, për shembull, do të ishin subjekt i një vendimi redaktues për ta publikuar materialin ose jo. Nga ana tjetër, komenti i një lexuesi i cili dërgohet automatikisht në një faqe mesazhesh mund të mos e ketë kaluar këtë proces. Si rrjedhojë, lloje të ndryshme materiali mund të jenë të hapura për nivele të ndryshme rregullimi. Gjithsesi, shmangia e mbikëqyrjes redaktuese nuk duhet të jetë një justifikim për të shmangur përgjegjësinë redaktuese.

## 5. Sfida më e madhe: të sigurohemi që publiku e di se mund të ankohet

### *A duhet të jetë publiku në dijeni të së drejtës së tij për t'u ankuar?*

Kjo është thelbësore. Asnjë organ vetërregullues nuk mund të jetë efektiv nëse njerëzit nuk janë në dijeni të së drejtës së tyre për t'u ankuar rreth atyre që lexojnë në gazeta, shohin në televizion apo dëgjojnë në radio.

Në disa vende, nivelet e ndërgjegjësimit të publikut janë shumë të larta. Kjo ndodh veçanërisht në vende si Norvegjia dhe Suedia ku këshillat e shtypit dhe komisionet e ankimit kanë ekzistuar për një kohë të gjatë. Gjithsesi, në disa vende të tjera mbetet ende shumë për t'u bërë për të siguruar që publiku të dijë si të shprehë shqetësimet e tij në lidhje me mediat. Organet vetërregulluese me më shumë burime – si Komisioni i Ankimit ndaj Shtypit në Mbretërinë e Bashkuar – janë, padyshim, të afta për të ofruar një ndërgjegjësim më të gjerë se organet me buxhet dhe personel më të vogël.

### *Si mund të rritet ndërgjegjësimi rreth të drejtës për t'u ankuar?*

Mënyra më e mirë është që vetë mediat të publikojnë informacion për t'i informuar lexuesit se si mund të ankohen. Për disa institucione mediatike kjo mund të jetë një mallkim – cila gazetë apo cili transmetues do që të tërheqë ankesa? Megjithatë, rëndësia e përgjegjësisë së mediave është theksuar dhe kjo është vetëm një pjesë e përbushjes së përgjegjësisë së tyre.

Ekzistojnë edhe masa të tjera. Fushatat e reklamimit janë efektive, megjithëse të kushtueshme. Ditët e hapura, kur publiku ftohet për t'u takuar me anëtarë të organit rregullues, mund të tërheqin një profil të lartë por mund të kërkojnë burime të konsiderueshme. Ndoshta metoda më e drejtpërdrejtë është publikimi periodik – mundësisht edhe i denjë për lajm – i informacionit rreth veprimtarive të organit vetërregullues për sa më shumë palë të interesuara që të jetë e mundur. Mbulimi nga mediat i këtyre veprimtarive do të rrisë

ndërgjegjësimin më shumë se çdo gjë tjetër.

### ***A mund të jetë proaktiv dhe të nisë hetime një organ vetërregullues, edhe kur nuk është bërë asnjë ankesë?***

Shumë organe vetërregulluese janë të afta të iniciojnë vetë ankesa, por shpeshësisht me të cilën e bëjnë këtë luhatet ndjeshëm.

Mund të jetë me rrezik iniciimi i një hetimi në rast se personat në qendër të artikullit apo transmetimit nuk janë ankuar vetë. Çdo njeri gëzon të drejtën absolute për t'u mos ankuar, për cilëndo arsye. Organet vetërregulluese mund të shkelin të drejtën e jetës private të individit sipas legjislacionit për të drejtat e njeriut në rast se ato iniciojnë hetime pa pëlqimin e personit të prekur.

Për më tepër, është shpesh e pamundur për këdo tjetër përveç personave të prekur që ta dinë se sa fyes ka qenë në të vërtetë një artikull apo transmetim: mund të jetë bërë me bashkëpunimin e plotë të palës në dukje të dëmtuar. Një organ vetërregullues i përqendruar në ndërmjetësim nuk mund ta dijë se çfarë do të konsiderohej si një zgjidhje e përshtatshme nga individët e përfshirë në rast se këta të fundit nuk ankohen. Ata që kërkojnë të gjykojnë do ta kishin të vështirë të përftonin një panoramë të plotë të situatës pa këndvështrimin e aktorëve kryesorë.





## Kapitulli 4

# Këshilli i shtypit

## Prototipi i një organi vetërregullues

*Nga Ognian Zlatev*

“Këshilli i shtypit” është forma më e përhapur e një organi vetërregullues. Të përbërë kryesisht nga profesionistë të mediave, këto këshilla janë të pavarur nga pushteti politik. Detyra e tyre kryesore është trajtimi i ankesave rreth punës së mediave, përmes vendimmarrjes kolektive. Duke bërë këtë, ata i ofrojnë publikut garanci për cilësinë e informacionit që merr, demonstrojnë se profesionistët e mediave janë të përgjegjshëm dhe tregojnë që rregullimi i vazhdueshëm i shtetit mbi mediat nuk është i nevojshëm.

Secili këshill shtypi i ngritur është unik, rezultat i historisë së veçantë të vendit të tij dhe i mjedisit mediatik. Sfida e këtij kapitulli është të shohim përtej veçorive kombëtare për t'u ofruar informacion profesionistëve të mediave të cilët po përpiqen të krijojnë, drejtojnë apo transformojnë një organ të tillë.



## 1. Funkzioni thelbësor i një këshilli shtypi

### *Për çfarë shërben një këshill shtypi?*

Një këshill shtypi në thelb shërben për të ndërtuar besim dhe besueshmëri tek mediat; për të përmirësuar standardet e cilësisë në institucionet mediatike; për të parandaluar ndërhyrjen nga shteti dhe autoritete të tjera; dhe për të ulur numrin e çështjeve gjyqësore kundër gazetarëve.

### *Cilat janë detyrat bazë të një këshilli shtypi?*

Detyrat kryesore të një këshilli për shtyp janë:

- Të pranojë ankesat;
- Të verifikojë që ankesat bien në kategorinë e kodit të etikës;
- T'i shqyrtojë ato tërësisht nga çdo këndvështrim;
- Të shërbejë si ndërmjetës mes ankuesit dhe medias;
- Të marrë vendime të drejta për ankesat, bazuar në rregulla dhe rregullore;
- T'i tërheqë vëmendjen medias që ka shkelur direktivat e etikës;
- Të sigurojë transparencë dhe publicitet për të gjitha vendimet e marra;
- Të analizojë dhe komentojë mbi tendencat e mediave dhe të ofrojë orientim rreth kërkesave të kodit;
- Të sugjerojë ndryshime në kodin e etikës (nëse e kanë këtë mandat);
- Të vendosë standarde profesionale të gazetarisë;
- Të mbrojnë lirinë e shtypit.

***Cilat janë përfitimet e një këshilli shtypi krahasuar me mekanizmat e tjera vetërregulluese?***

Këshillat e shtypit, si organe kolektive, gëzojnë përfaqësimin më të lartë të mundur dhe si rrjedhojë, besueshmëri më të madhe. Ato janë forma më bashkëvepruese e vetërregullimit pasi lejojnë shqyrtimin e të gjitha këndvështrimeve.

***Çfarë është jetësore për një këshill shtypi aktiv?***

Duhet të përfshijë përfaqësues nga të gjithë aktorët — gazetarë, redaktorë, pronarë të mediave dhe anëtarë të publikut. Të gjithë duhet të jenë të pranuar nga publiku dhe të përkushtuar për të ndërtuar besimin në konceptin e vetërregullimit. Këshilli duhet t'i përcaktojë vetë rregullat dhe procedurat e punës.


## 2. Këshillat e shtypit në zonën e OSBE-së

Janar 2008 (në bazë të të dhënave të disponueshme)

### *Ku ekzistojnë tashmë këshillat e shtypit?*

Disa vende kanë ngritur këshilla shtypi prej kohësh: Gjermania, Vendet e Ulëta dhe Skandinave, për shembull.

Vende të tjera, si Belgjika, i kanë ngritur ato vetëm kohët e fundit. Ndryshimet demokratike të kohëve të fundit në vende si Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Gjeorgji dhe Armeni kanë sjellë një shpërthim mediash të pavarura, gjë që ka sjellë nevojën për vetërregullim të mediave. Megjithëkëtë, ka vende ku këshillat e shtypit nuk ekzistojnë ose kanë reshtur së ekzistuari, si për shembull në Austri, Francë ose Portugali.



SHBA

KAN\*

Vende me këshilla shtypi të ngritur prej kohësh

Vende me këshilla shtypi të rinj (pas vitit 2000)

Vende pa këshilla shtypi



\* Këshilla shtypi rajonale (në Katalonja në Spanjë dhe në Rajonin Flamand në Belgjikë)



***Pse disa vende nuk kanë këshilla shtypi?***

Arsyet kryesore pse këshillat e shtypit nuk ekzistojnë janë:

- Politike: vende, për shembull, ku qeveria përpiqet të censurojë mediat;
- Ekonomike: vende ku mediat përdoren thjesht për përfitime monetare ose për të ruajtur interesat e elitave politike dhe të biznesit, ose ku tregu i mediave është shumë i vogël;
- Ligjore: vende ku ekzistojnë ligje për mediat e shtypura dhe elektronike të cilat trajtojnë çështje të etikës dhe saktësisë;
- Kulturore: vende ku profesionistët e medias kundërshtojnë vetërregullimin.

***Pse disa profesionistë të mediave janë kundër këshillit të shtypit?***

Vetërregullimi ka qenë një proces i ngadaltë dhe i hapur madje edhe në demokracitë e konsoliduara dhe disa gazetarë mendojnë se këshilli i shtypit kërcënon lirinë e shtypit. Standardet e gazetarisë debatohen me forcë në mbarë globin. Disa teoricienë argumentojnë për objektivitetin, përmes paanësisë, pluralizmit të brendshëm dhe neutralitetit në mbulimin e çështjeve politike dhe morale.

Të tjerë e shohin rendjen pas gazetarisë objektive si një mision të pamundur dhe si rrjedhojë kundërshtojnë idenë e këshillave të shtypit.

***Ku mund të gjej informacion rreth këshillave të shtypit ekzistues?***

Këto dy faqe interneti ofrojnë informacion të bollshëm:

- [www.media-accountability.org](http://www.media-accountability.org)
- [www.wanewscouncil.org](http://www.wanewscouncil.org)

Përfaqësues të këshillave të shtypit ekzistues mund të kontaktohen përmes faqeve të internetit ose duke marrë pjesë në takimet e tyre vjetore të Aleancës për Këshilla Shtypi të Pavarur në Evropë (AIPCE).

### 3. Pyetjet që duhen bërë përpara se të ngrihet një këshill shtypi

#### *A ka një model shabllon për një këshill shtypi?*

Është e mundur që, duke shqyrtuar këshillat e shtypit ekzistues, të ndërtohet një model i kornizës dhe strukturës së përgjithshme për sa i përket mediave “tradicionale” (radio, televizioni dhe shtypi), por përtej kësaj, çdo këshill shtypi duhet të marrë parasysh veçoritë e vendit, si legjislacioni, kultura, tradita e medias dhe pjekuria e demokracisë.

#### *A është një këshill shtypi i përshtatshëm për të gjitha llojet e mediave?*

Në teori, po. Në realitet, varet nga specifikat kombëtare dhe nga shkalla e zhvillimit të mediave.

Shumica e këshillave të shtypit anembanë botës janë ngritur kryesisht për të vetërregulluar median e shkruar, pasi transmetimet shpeshherë rregullohen me akte staturore dhe ligje të tjera. Gjithsesi, zhvillimet e fundit në vende ku gazetat kanë investuar shumë në median elektronike kanë sjellë futjen e rregulloreve për të mbuluar marrëdhënien ndërmediatike mes televizionit dhe gazetave.

#### *A kërkon ngritja e një këshilli shtypi legjislacion të ri?*

Jo. Në shumicën e vendeve një këshill shtypi ngrihet dhe anëtarët e tij zgjidhen nga gjiri i aktorëve kryesorë pavarësisht legjislacionit specifik. Ka disa vende të rralla me këshilla shtypi statutorë, si Danimarka, ku qeveria ka ngritur një Këshill Shtypi Danez pasi një organ vetërregullues u shpërbë në vitin 1992 për shkak të mosmarrëveshjeve ekonomike mes gazetarëve dhe pronarëve të mediave dhe mungesës së përkrahjes nga shumë institucione të medias.

### ***Cilat janë rreziqet e një këshilli shtypi statutor?***

Pavarësia e një këshilli shtypi të tillë është e diskutueshme. Kjo pavarësi është veçanërisht në rrezik në vendet në tranzicion ku proceset demokratike janë ende të brishta. Mund të kenë ende ndikim politik mbi mediat dhe një nivel të lartë vetëcensurimi nga profesionistët e mediave si pasojë e modeleve të kaluara të sjelljes politike për mbijetesë. Ndaj këshillat e shtypit statutorë duhen shmangur.

### ***A kërkon ngritja e një këshilli shtypi adoptimin e një kodi të ri etike?***

Jo medoemos. Shumica e kodeve të etikës e përfshijnë këshillin e shtypit si një mekanizëm për zbatimin e tyre. Në rast se një kod nuk parashikon ngritjen e një këshilli shtypi, atëherë ai duhet ndryshuar.

Në disa vende, adoptimi i një kodi të ri etike ka qenë hapi i parë drejt krijimit të një këshilli shtypi, duke ndërtuar kështu konsensus që përpara themelimit të këshillit.

## 4. Struktura dhe rregullat e këshillit të shtypit

### *Si të zgjedhim strukturën më të përshtatshme për kushtet lokale?*

Nuk ka një zgjidhje universale. Kjo varet, mes së tjerash, nga traditat demokratike, kultura, zhvillimi i medias, niveli i lirisë së shtypit, gjeografia, administrimi dhe pushteti vendor i një vendi. Edhe dallimet gjuhësore mund të luajnë rol në disa vende.

Në rast se vendi është i madh, me shumë ndarje administrative, pushtete vendore relativisht autonome dhe dallime domethënëse në tregun rajonal, përgjigja mund të jetë struktura rajonale. Gjithsesi, këto do t'i shërbenin vetëm mediave rajonale dhe nuk mund të përjashtohet ekzistenca e një strukture kombëtare. Këshillat rajonalë të shtypit mund ta kenë më të vështirë që të jenë të pavarur, për arsye subjektive dhe financiare. Sa më i vogël të jetë rajoni, aq më e madhe është mundësia për konflikt interesi.

Në shumicën e raste, sa më qendror, i pavarur, i fortë dhe i respektuar të jetë një këshill shtypi, aq më mirë. Këshillat rajonalë të shtypit nuk duhet të ngrihen pa një analizë të hollësishme të efektit që vetërregullimi mund të ketë mbi mediat.

### **Krijimi i Këshillit të Shtypit Bullgar**

Debatet rreth vetërregullimit të mediave në Bullgari u intensifikuan me lulëzimin e mediave të pavarur në fillim të viteve '90. Ashtu si në shumicën e demokracive të reja, fillimisht diskutohej mes një rrethi të ngushtë akademikësh, teoricienësh dhe organizatorësh të mediave dhe Sindikatës së Gazetarëve. Jo më pak se shtatë versione të kodit të etikës u krijuan për mediat bullgare gjatë viteve 1990 dhe 2002, por nuk u krijua asnjë mekanizëm për t'i zbatuar ato.

Vetëm pas përfshirjes aktive të pronarëve të mediave u morën hapa praktike dhe u arritën rezultate të dukshme. Asistenca e huaj, përmes projekteve të financuara nga BE/PHARE, ishte dobishme, por puna e vërtetë, strategjia, diskutimet dhe idetë erdhën nga të gjitha palët e përfshira.

Më 25 nëntor 2004, Kodi i Etikës për mediat bullgare u nënshkrua nga përfaqësues të shumicës së mediave të Bullgarisë në prani të Presidentit të Republikës, Kryeministrit dhe Kryetarit të Parlamentit. Por u deshën edhe tetë muaj të tjerë përpara ngritjes së organit zbatues të këtij kodi – Këshilli Kombëtar për Etikën në Gazetari ([www.mediaethics-bg.org](http://www.mediaethics-bg.org)) — i cili tani punon me kapacitet të plotë.

### ***Si vendosen dhe adoptohen rregullat e këshillit të shtypit?***


Në përgjithësi, rregullat diskutohen dhe adoptohen pas diskutimeve me të gjithë aktorët (gazetarët, redaktorët, pronarët e mediave, konsumatorët e mediave dhe publiku). Shumë varet nga kuadri ligjor në secilin vend. Në disa vende, si Mbretëria e Bashkuar, rregullat janë zhvilluar nga vetë industria e mediave. Vendet në tranzicion ose në fazat e para të zhvillimit të vetërregullimit të mediave kanë kërkuar asistencën e bashkësisë ndërkombëtare.

### ***Si është i strukturuar zakonisht një këshill shtypi?***

Normalisht ekziston një bazë themelore e përbërë nga anëtarë bordi të cilët janë përgjegjës për të drejtuar organizatën dhe për të menaxhuar financat e saj. Nën mbikëqyrjen e këtij themeli, ngrihen një ose më shumë komisione të tjera të ngarkuara për të marrë dhe trajtuar ankesat rreth punës së mediave. Këto komisione përbëhen gjithashtu nga anëtarë bordi të cilët mund të jenë të ndryshëm nga ata të bazës.

### ***A është struktura e njëjtë si për median e shkruar ashtu edhe për median e transmetimeve/elektronike?***

Roli parësor i këshillit të shtypit është të menaxhojë ankesat për shkelje të kodit të etikës. Në shumicën e rasteve, një këshill shtypi është i strukturuar njëloj për arsyen e thjeshtë se shumica e ankesave janë të ngjashme si për median e shkruar ashtu edhe për atë të transmetimeve.



## 5. Anëtarët dhe anëtarët e bordit të këshillit të shtypit

### *Kush duhet të jetë anëtar i këshillit të shtypit?*

Duhet të jetë i përbërë kryesisht nga gazetarë, pronarë mediash dhe botues. Anëtarësimi plotësohet zakonisht përmes shoqatave profesionale.

### *A duhen përfshirë të gjitha institucionet e mediave?*

Nëse shumë institucione mediash refuzojnë t'i përmbahen një kodi etike dhe të aderojnë në një këshill shtypi, kjo do të ngrijë tërësisht konceptin e vetërregullimit dhe do t'i japë shtetit një justifikim për të ndërhyrë. Do të dëmtojë imazhin e medias si një biznes modern që zbaton standarde të larta profesionale. Në një afat më të gjatë, kjo mund të dëmtojë besueshmërinë dhe cilësinë e informacionit të ofruar nga media.

### *A duhen bërë botuesit anëtarë të këshillit të shtypit?*

Botuesit janë një pjesë e domosdoshme e vetërregullimit të medias dhe nëse nuk luajnë rol redaktues. Përmes financimit dhe botimeve, ata luajnë një rol indirekt në përcaktimin e standardeve. Mungesa e tyre mund të demotivojë gazetarët dhe të zvogëlojë nivelin e respektimit të standardeve. Nevoja që botuesit të jenë anëtarë të këshillit të shtypit duhet promovuar si një përgjegjësi sociale e përbashkët gjithëpërfshirëse e medias si biznes.

Këshillat e shtypit në disa vende janë ngritur pa mbështetjen e botuesve apo pronarëve të mediave, si në Zvicër. Gjithsesi, përvoja tregon se këshillat e shtypit me një përfshirje të botuesve dhe pronarëve të mediave gëzojnë respekt më të lartë profesional dhe publik.

**Po “shtypi i verdhë”, i cili prirët ta shpërfillë kodin e etikës, a duhet përfshirë?**

Nëse këto media e kanë nënshkruar kodin e etikës, ato duhen përfshirë në mënyrë të barabartë me të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë përkatëse. Nëse nuk e kanë nënshkruar, ato nuk përbëjnë një rrezik për këshillin e shtypit. Shumica e këshillave të shtypit nuk bëjnë dallim mes medias kryesore dhe shtypit "të verdhë", por mes medias profesionale dhe joprofesionale.

**Anëtarët e këshillit të shtypit në Vendet e Ulëta**

Këshilli i Shtypit i Vendeve të Ulëta ([www.rvdj.nl](http://www.rvdj.nl)) është ngritur dhe drejtohet nga një fondacion i quajtur *Stichting Raad voor de Journalistiek*. Aty marrin pjesë të gjitha organizatat e rëndësishme të mediave:

- Sindikata e Gazetarëve të Vendeve të Ulëta (*Nederlandse Vereniging van Journalisten*);
- Shoqata e Kryeredaktorëve të Vendeve të Ulëta (*Nederlands Genootschap van Hoofdredacteuren*);
- Agjencia Kombëtare e Lajmeve të Vendeve të Ulëta (*Algemeen Nederlands Persbureau*);
- Disa organizata të koordinuara të shtypit;
- Organizata koordinuese të transmetimeve publike dhe komerciale;
- Organizata e Internetit Planet Internet.

**Kush duhet të shërbejë si anëtar bordi?**

Ekzistojnë praktika të ndryshme. Në shumicën e rasteve, këshillat e shtypit përfshijnë përfaqësues nga grupet kryesore profesionale dhe anëtarë të shquar të publikut. Zyrtarët publikë mund të përfaqësohen, në varësi të vendit dhe cilësive personale të zyrtarëve, por pjesëmarrja e tyre duhet të jetë e kufizuar dhe e përcaktuar në marrëveshje me të gjithë aktorët.



Përfaqësuesit e publikut luajnë një rol të rëndësishëm në 80 përqind të këshillave të shtypit. Kjo sjell përfitime domethënëse pasi i jep organit besueshmëri më të madhe, siguron transparencën dhe llogaridhënien e tij dhe pikëpamje të paanshme dhe shërben si zëri i konsumatorëve të mediave, sidomos në vendet që nuk kanë shoqata për konsumatorët e mediave.

### ***Si duhet të emërohen anëtarët e bordit?***

Anëtarët e bordit duhen emëruar përmes një procedure demokratike. Zakonisht kjo bëhet përmes emërimeve dhe votimeve nga komuniteti i profesionistëve dhe institucionet e mediave që kanë nënshkruar kodin e etikës dhe kanë pranuar këshillin e ardhshëm të shtypit. Një mundësi tjetër, e zgjedhur nga Mbretëria e Bashkuar, është që anëtarët të emërohen nga një komision përzgjedhës i pavarur.

### ***Cilat janë detyrat e anëtarëve të bordit?***

Praktikat luhaten, por kryesisht anëtarët e bordit sigurojnë që këshilli i shtypit të veprojë në përputhje me misionin e tij dhe të operojë në pajtim me parimet e tij kryesore. Ata gjithashtu miratojnë rregullat dhe rregulloret për trajtimin e ankesave. Në disa raste, ata ofrojnë orientim në zgjidhjen e çështjeve më të ndërlikuara. Ata kontribuojnë kryesisht në rritjen e ndërgjegjësimit dhe në promovimin e konceptit të vetërregullimit.

### ***A punojnë me kohë të plotë anëtarët e bordit?***

Jo, ata shërbejnë në kohën e tyre të lirë. Takimet e bordit luhaten në shpeshhtësi në varësi të rregullave individuale të procedurës. Në Bullgari, bordi, mandati i të cilit është të trajtojë më shumë çështje strategjike, mbliidhet mesatarisht tri herë në vit.

***A ka nevojë këshilli i shtypit për një personel administrativ për të punuar çdo ditë?***

Kjo siguron mbarëvajtjen e procesit të vlerësimit të ankesave – përpunimi i ankesave të përditshme, parapërzgjedhja, mbledhja e informacionit shtesë, përgatitja e mbledhjeve të bordit, organizimi i ndërhyrjes së ekspertëve të jashtëm kur është e nevojshme dhe organizimi i publikimit të vendimeve dhe rezolutave të këshillit të shtypit.

## 6. Anëtarët e ngarkuar me trajtimin e ankesave

### *Sa anëtarë duhet të jenë përgjegjës për trajtimin e ankesave?*

Kjo varet nga numri i institucioneve të mediave të përfshira në vetërregullim dhe nga rrethanat kombëtare. Numri duhet të jetë i madh mjaftueshëm që të dëgjohen këndvështrime të ndryshme, gjë që ndihmon në ruajtjen e objektivitetit të këshillit dhe ndërton besim në idenë e vetërregullimit, por jo aq i madh sa të mos arrihet një përfundim i përbashkët. Numri duhet të jetë tek në mënyrë që të shmanget barazimi i votave. Një numër optimal mund të ishte nga 7 deri në 11 anëtarë.

### *A duhet të kenë përgatitje gjyqësore?*

Sigurisht që jo. Kodi i etikës nuk është një dokument ligjor zyrtar dhe këshillit nuk i duhet të marrë vendime juridike. Anëtarët duhet të kenë integritet moral personal dhe profesional dhe jo medoemos njohuri ligjore. Ndryshe nga vendimet gjyqësore që e ndërthurin drejtësinë me ndëshkimin, vendimet e këshillit të shtypit janë korrigjuese, duke mbrojtur standardet e gazetarisë dhe të drejtën e shoqërisë për të marrë informacion objektiv. Këto vendime nuk përjashtojnë një padi të mundshme gjyqësore për llogari të palës ankuese.

## 7. Financimi i këshillit të shtypit

### *Si duhet financuar një këshill shtypi?*

Mënyra më e mirë për të financuar një këshill shtypi është një sistem që të sigurojë pavarësinë e tij. Idealja është që të ketë një larmi burimesh financimi, me kontributet më të mëdha nga industria e medias, si në Vendet e Ulëta ose Suedi, ose të ndara në mënyrë të barabartë mes pronarëve dhe gazetarëve, si në Norvegji. Gjithsesi, në disa vende, si në Zvicër, financimi bëhet vetëm nga gazetarët. Në vendet në tranzicion ose në fazat fillestare të zhvillimit të vetërregullimit, një rol madhor duhet luajtur nga donatorët ndërkombëtarë.

### *Cili është roli i shtetit në financimin e këshillit të shtypit?*

Në disa vende — si Luksemburgu dhe Qipro — përfshirja financiare e shtetit pranohet pasi mediat publike i nënshtrohen gjithashtu kodit të etikës. Një përfshirje e tillë duhet të kontrollohet nga mekanizma të forta për të parandaluar ndërhyrjen e shtetit në punën e këshillit.

### *Nëse një këshill shtypi financohet kryesisht nga industria e medias, si mund të jetë i paanshëm ky organ?*

Kjo duhet garantuar nga procedura të qarta dhe mekanizma transparente. Procesi i financimit dhe procesi i vendimeve në lidhje me ankesat duhet të jenë të ndarë nga njëri-tjetri.

### *Ç'lloje mekanizmash mund të zhvillohen?*

Financimi mund të bazohet në kuota anëtarësimi ose në natyrën e institucioneve të mediave, duke marrë parasysh madhësinë e tirazhit dhe të biznesit. Një regjistër transparent duhet mbajtur me të gjithë donatorët e tjerë dhe të gjitha institucionet e mediave të përfshira në organin vetërregullues duhet të kenë akses të garantuar tek ai. Raportet vjetore të këshillit të shtypit duhet të përmbajnë një deklaratë financiare me kontributet e secilit institucion mediatik.

Shumica e anëtarëve të komisioneve vendimmarrëse duhet të jenë njerëz pa lidhje me mediat dhe rregullat e këshillit duhet ta shprehin qartë që vendimet nuk duhet të kenë në asnjë mënyrë lidhje me financimin ose dhurimet nga institucionet mediatike.

### ***Si mund të sigurohen financime për këshillin e shtypit?***

Së pari, përmes kontributeve vjetore nga të gjitha mediat të cilat kanë rënë dakord t'i përmbahen kodit të etikës dhe të respektojnë vendimet e këshillit të shtypit. Financimi mund të sigurohet gjithashtu duke nxitur këshillin e shtypit që të angazhohet në veprimtari të ndryshme, si botime vjetore, zhvillimi i projekteve dhe bazave të të dhënave dhe organizimi i fushatave për mbledhjen e fondeve për çështje specifike. Për burimet e financimit duhen mbajtur të dhëna të sakta.

Një shembull i një praktike të mirë është fushata promovionale bullgare “Zgjidh Produkt Bullgar”, në të cilën secila media që merrte pjesë pranoi të dhuronte një përqindje të të ardhurave të tyre për këshillin e shtypit.

**Dhjetë gjëra për të cilat duhet rënë dakord përpara ngritjes së këshillit të shtypit:**

1. Të mblidhen të gjitha mediat
2. Të merret pëlqimi i redaktorëve
3. Të merret pëlqimi i botuesve
4. Të fitohet mbështetja e qeverisë dhe publikut
5. Të hartohen direktiva etike të përbashkëta dhe të bihet dakord për to
6. Të evidentohen kostot dhe financimet e mundshme
7. Të diskutohet dhe të vendoset struktura e organit (personeli, mediat)
8. Të vendoset pushteti i organit (proaktiv, si të trajtohen ankesat)
9. Të rritet ndërgjegjësimi rreth kodit të etikës mediave dhe përmes trajnimit të gazetarëve
10. Të bashkëpunohet me organe të tjera të ngjashme dhe të shkëmbehet përvojë

## 8. Krijimi i këshillave të shtypit në demokracitë e reja

### *Cilat janë sfidat kryesore ndaj krijimit të këshillave të shtypit në demokracitë e reja?*

Sfidat kryesore janë:

- Mungesa e traditës dhe përvojës me vetërregullimin;
- Ndarjet politike që përçajnë komunitetin e mediave: si rezultat, mungesa e dialogut dhe solidaritetit mes fraksioneve të ndryshme i pengon gazetarët që të mbrojnë njëzëri interesat e tyre të përbashkëta;
- Tregu i vogël mediatik dhe moszhvillimi i përgjithshëm i ekonomive kombëtare: vetëm pak gazeta dhe transmetues mund të mbijetojnë, ndërsa të tjerave u duhet të rreshtohen në krahë të forcave politike për të fituar mbështetje financiare;
- Trysnia e vazhdueshme politike mbi mediat, sidomos mbi mediat publike, për të qenë besnike ndaj pushtetit dhe për të shmangur gazetarinë kritike;
- Bashkëpunimi i ngushtë dhe ndërvarësia mes elitave politike dhe grupeve të biznesit që kanë interes në industrinë e mediave, duke i ekspozuar gazetarët para varësisë politike dhe ekonomike.

### *A mund të krijohen këshilla shtypi në vendet ku forcat politike kundërshtojnë vetërregullimin?*

Ky është një problem tipik për vendet në tranzicion. Këshillat e shtypit mund të krijohen me përfshirjen aktive të bashkësisë ndërkombëtare. Për të garantuar suksesin e një organi të ri vetërregullues, çështja mund të përfshihet në axhendën e marrëdhënieve politike ndërkombëtare të vendit.

***Si mund të operojë një këshill shtypi nëse shumica e organeve të medias janë nën mbikëqyrjen e qeverisë?***

Në vendet me një traditë të gjatë demokratike, pronësia e mediave nuk ndikon në vetërregullimin e mediave. Por ngritja e një këshilli shtypi të pavarur dhe efikas në vendet me qeveri totalitare, ku shumica e mediave janë pronë e shtetit, është tejet e vështirë. Megjithëkëtë, këshillat e shtypit ekzistojnë njëfarësoj edhe në disa shtete afrikane ku liria e shtypit përbën ende një shqetësim ndërkombëtar.

Në mbarë botën, strukturat qeveritare përfshijnë ministrinë e informacionit dhe komunikimit të cilat luajnë një rol të madh e ndonjëherë mjaft të diskutueshëm në etikën dhe vetërregullimin e mediave. Është e domosdoshme që në këto vende të bisedohet me qeveritë për t'i bindur ato për përfitimet që mbart vetërregullimi i mediave.

***Si mund të shmangin gazetat trysninë nga reklamuesit, nga vullneti i mirë i të cilëve varet mbijetesa e shumë gazetave?***

Kjo arrihet duke krijuar një strukturë organizative që ndan qartë përgjegjësitë e redaksive të lajmeve dhe të reklamimit. Kodet e praktikës duhet të përfshijnë rregulla për shmangien e konfliktit të interesave, duke deklaruar që gazetarët nuk duhet të ndikohen nga faktorët komercialë, përfshirë interesin e reklamuesve, në përgatitjen e artikujve. Mediat duhet të vendosin rregulla për pranimin e dhuratave nga kompanitë ose për pagesën e kostove për përgatitjen e materialeve, përfshirë udhëtimin dhe marrjen e mostrave.

Trysnia e reklamuesve shmanget gjithashtu duke nxitur konkurrencën në media, transparencën e pronësisë, monitorimin e pavarur të besimit të publikut në mediat dhe duke botuar raporte vjetore të përbashkëta dhe financiare. Diskutime mes përfaqësuesve të reklamuesve dhe agjencive reklamuese me shoqatat e gazetarëve/redaktorëve duhen inkurajuar.



***Si mund të kapërcehen dallimet politike të profesionistëve të mediave për të krijuar një organ vetërregullues të vetëm?***

Këshillat e shtypit janë organe profesionale dhe jo politike ku duhet të mbizotërojnë cilësitë profesionale të përfaqësuesve të mediave. Procedura të shëndosha për shmangien e konfliktit të interesit duhen vendosur për të garantuar paanshmërinë politike. Këto procedura mund të përfshijnë një rregull që anëtarët e organeve vendimmarrëse të partive politike nuk mund të jenë anëtarë bordi të një këshilli shtypi dhe një kusht që anëtarët të nënshkruajnë një deklaratë për të shmangur konfliktin e interesit.

***Çfarë mund të bëhet nëse organi nuk merr ankesa të mjaftueshme?***

Pikësëpari, këshilli i shtypit duhet të hetojë përse po ndodh kjo. Zakonisht ndodh për shkak se nuk ka informacion dhe publicitet të mjaftueshëm rreth këshillit. Mund të jetë edhe që procedura e ankimit është tepër e ndërlikuar ose që ka një mungesë besimi në anëtarët e këshillit. Masat e duhura duhen marrë në varësi të arsyeve të evidentuara.

Numri i ankesave të paraqitura luhetet mjaft nga vendi në vend. Numri mesatar në Mbretërinë e Bashkuar është 3.500 dhe vetëm për 300 prej tyre merret vendim; në Gjermani mesatarja është 400; në Vendet e Ulëta vetëm 80.

## Kapitulli 5

# Ombudsmani

## Vetërregullimi brenda një institucioni mediatik

*Nga Véronique Maurus*

Ndryshe nga këshillat e shtypit, shumica e ombudsmanëve punojnë vetëm për një organ mediatik specifik. Ata shërbejnë si urë lidhëse mes personelit të organit mediatik dhe përdoruesve (lexuesit, shikuesit ose dëgjuesit), marrin komentet dhe ankesat e tyre dhe përpiqen të zgjidhin mosmarrëveshjet mes dy palëve.

Ky kapitull shqyrton funksionet e ombudsmanit, ofron direktiva se si të krijohet ky pozicion dhe eksploron vështirësitë e kësaj pune.



## 1. Evolucion i ombudsmanit

### *Si nisi vetërregullimi në një media?*

Fillimisht, forma më e përhapur ishte një zyrë e thjeshtë ankesash. Në *New York World* në vitin 1913, një punonjës mbante shënim ankesat e lexuesve të pakënaqur dhe ua kalonte redaktorëve. Ky model u adoptua në vitin 1920 nga *Detroit News* në Miçigan dhe, në mënyrë më të organizuar, nga *Asahi Shimbun* në Tokio, ku një komision hetonte ankesat dhe ia përcillte ato kryeredaktorit.

Fjala “Ombudsman”, që në suedisht do të thotë “përfaqësues”, është adoptuar gjerësisht edhe nga gjuhë të tjera me kuptimin e ndërmjetësuesit (cilado gjini) i cili heton ankesat e qytetarëve. Për herë të parë u aplikua në shtyp nga e përditshmja *Courier-Journal* në Louisville, Kentaki, e cila në vitin 1967, caktoi një ish-kryetar të informacion vendor për të trajtuar marrëdhëniet me lexuesve dhe gazetarëve. Hapi tjetër u ndërmor në vitin 1970 nga *Washington Post*, i cili caktoi një zëvendës redaktor për të dëgjuar ankesat e lexuesve, për të shkruar qarkore të brendshme dhe për të botuar një rubrikë ku ishte i lirë të shprehte mendimin e tij. Gradualisht sistemi u përmirësua, duke u bërë gjithnjë e më bashkëveprues ndërsa komentet, kritikata, vëzhgimet dhe korrigjimet përpunoheshin, përcilleshin dhe iu ktheheshin lexuesve.

Shembulli u ndoq dhe në vende të tjera të botës. Gjithsesi, edhe sot vetëm dy përqind e të përditshmeve në SHBA kanë ombudsmanë dhe në vende të tjera janë edhe më të rrallë.

### **Krijimi i ombudsmanit në *Le Monde***

*Le Monde* është përpjekur gjithnjë të mbajë lidhje të afërta me lexuesit e saj. Në vitet '60, drejtori, me ndihmën e zëvendësit, iu përgjigj vetë letrave duke botuar ekstrakte dhe duke marrë masa që të gjitha gabimet e evidentuara të korrigjoheshin.

Në vitin 1994, pas një krize të thellë besimi dhe humbjeje të lexuesve, një ombudsman u caktua për të drejtuar departamentin e letrave të lexuesve dhe për të ripërtërirë dialogun mes lexuesve dhe redaktorëve. Kjo funksionoi, me gjithë se pas disa vjetësh, marrëdhëniet mes drejtuesve dhe ombudsmanit u tensionuan.

Ombudsmani është krejtësisht i pavarur nga kryeredaktori dhe i jep llogari vetëm drejtorit menaxhues, i cili bën emërimin e tij. Ombudsmani nuk mund të vendosë sanksione, por shpreh mendime në një rubrikë javore, duke qenë i lirë për të zgjedhur temën për diskutim. Rubrika nuk mund të redaktohet, shkurtohet apo të ndryshohet pa lejen e ombudsmanit.

Një statut i brendshëm ose manual stili u botua në vitin 2002. Kjo "bibël" me 212 faqe, e ripunuar në vitin 2004, përmban rregulla praktike (drejtshkrim, shkurtime, emra të përveçëm, etj.) dhe një kod etike për personelin redaktues. Ombudsmani garanton që statuti të respektohet, monitoron rëndësinë dhe zhvillimin e tij dhe sigurohet që korrigjimet të botohen.

### ***A ekziston ombudsmani vetëm në median e shkruar?***

Jo. Në Francë, për shembull, stacionet private të radios dhe televizionit kanë luajtur një rol novator. *France 2*, *France 3* dhe *Radio France Internationale* kanë pasur ombudsmanë që nga viti 1998, pak kohë pas *Le Monde* dhe përpara shumë gazetave të tjera si *La Dépêche du Midi* (2001), *Midi Libre* (2004), *Sud-Ouest* (2006) dhe *l'Express* (2006).

***Ku mund të gjendet informacion rreth ombudsmanit?***

Organizata e Ombudsmanëve të Mediave (ONO) është një shoqatë ndërkombëtare me 60 anëtarë. Shumica e anëtarëve të saj vijnë nga Shtetet e Bashkuara (35 botime të regjistruara), duke u ndjekur shumë prapa nga Mbretëria e Bashkuar dhe Vendet e Ulëta (tri secila), dhe Suedia dhe Turqia (dy). Franca përfaqësohet nga një gazetë, *Le Monde*, dhe dy televizione publike, *France 2* dhe *France 3*. Vende të tjera me vetëm një përfaqësues të medias së shkruar janë Brazili, Kanadaja, Danimarka, Izraeli, Spanja, Portugalia dhe Japonia.

Ombudsmanët mund të kontaktohen përmes sindikatave të gazetarëve ose duke u lidhur me mediat që kanë ombudsman: një listë e tyre mund të gjendet në ONO ([www.newsombudsmen.org](http://www.newsombudsmen.org)).

## 2. Puna e ombudsmanit

### *Çfarë funksionesh ka ombudsmani?*

Ombudsmani nxit dialogun mes lexuesve, dëgjuesve dhe shikuesve të mediave dhe atyre që punojnë për mediat. Ideja është që përdoruesve t'u jepet një mundësi kontakti dhe, duke nxitur autokritikën, të forcohet besueshmëria e medias, sidomos nëse nuk gëzon imazh të mirë.

### *Cili është roli i ombudsmanit?*

Ombudsmani garanton respektimin e rregullave dhe zakoneve të vendosura nga organi i medias, duke ushtruar një lloj kontrolli të brendshëm cilësie.

Ekziston një kontratë e pashkruar me audiencën për të:

- Ofruar informacion sa më të saktë, të plotë dhe të qartë;
- Bërë një dallim të qartë mes informacionit dhe komenteve;
- Korrigjuar gabimet;
- Pasqyruar pluralizmin dhe larminë e mendimeve;
- Garantuar që të drejtat e individit të mos dhunohen dhe që jeta e tyre private të respektohet.

### *A është roli i ombudsmanit i njëjtë në çdo media?*

Luhatet ndjeshëm nga njëra media tek tjetra. Disa ombudsmanë u fërkojnë shpatullat gazetarëve, ndërsa të tjerët ruajnë distancën dhe nuk kanë aspak lidhje me botimet e tyre të përditshme. Disa thjesht përmbledhin letrat që kanë marrë nga publiku; disa shkruajnë shënime ose qarkore; disa i publikojnë vetë korrigjimet ose kanë një blog në Internet, ku u përgjigjen drejtpërdrejt komenteve të lexuesve. Të tjerë u përgjigjen pyetjeve praktike dhe ligjore të bëra nga lexuesit, megjithëse kjo mund të jetë në kufijtë e funksionit të tyre. Si përfundim, ka disa që veprojnë si zëdhënës dhe agjentë për marrëdhëniet me publikun në emër të drejtuesve.

### ***Cila është natyra e punës së përditshme të ombudsmanit?***

Ombudsmani mbledh kritika dhe sugjerime nga përdoruesit e mediave si dhe shpjegime nga bordi redaktues, drejtuesit apo administrata dhe përpiqet të pajtojë të dyja palët. Krahas funksionit si ndërmjetës, ombudsmani gjithashtu vëzhgon si operon media dhe vë re devijimet nga kontrata e pashkruar me lexuesit. Për median e shkruar, të gjitha këto aspekte botohen në një rubrikë periodike.

### ***A komunikon ombudsmani drejtpërdrejt me lexuesit, dëgjuesit dhe shikuesit?***

Po, padyshim. Ata janë burimi kryesor i informacionit dhe ligshmërisë së ombudsmanit. Pjesa më e madhe e komunikimit bëhet me korrespondencë të drejtpërdrejtë. Kjo nuk është shumë e vështirë, veçanërisht në ditët e sotme kur posta elektronike përdoret gjerësisht, me kushtin që ombudsmani të ketë një sistem të mirorganizuar për menaxhimin e korrespondencës. Është me rëndësi, për shembull, që të ketë dosje të mira dhe një farë përvoja në identifikimin (ose shmangien) e lobeve, sekteve, manipuluesve dhe letërdërguesve të vështirë (dhe ekzistojnë disa syresh!).

Në *Le Monde*, posta klasifikohet në katër kategori sipas shqetësimeve kryesore të lexuesve:

- Komente mbi lajmet në përgjithësi;
- Vërejtje gabimesh (mes lexuesve tanë ka një numër ekspertësh që kapen pas vogëlsirave e s'u shpëton gjë dhe gjejnë kënaqësi të veçantë në gjetjen e gabimeve);
- Komente mbi trajtimin që ne i bëjmë lajmit;
- Raportime rreth ngjarjeve që ata kanë dëshmuar ose ku janë përfshirë.



Është gjithashtu e mundur që të përdoret një blog në Internet, por kjo kërkon monitorim të vazhdueshëm dhe si rrjedhojë, personel shtesë.

### ***A pasqyron korrespondenca probleme me mediat?***

Korrespondenca bën të mundur që të identifikohen me shpejtësi tendencat e përgjithshme dhe mbi të gjitha, devijimet. Shumica e letërdërguesve janë të pakënaqur, por nuk ndodh gjithnjë me të njëjtët. Kur një pirlg me letra mbërrin papritur duke komentuar të njëjtin problem apo ndjesi, është e rëndësishme që media të jetë e ndërgjegjshme në mënyrë që të bëjë ndreqjet e duhurat. Posti i ombudsmanit është kështu një post dëgjese për përdoruesit e mediave.

### 3. Sanksionet e ombudsmanit

#### *Si i merr vendimet ombudsmani?*

Kur mbërrijnë kritikata (me letra, e-mail, telefon, etj.), ombudsmani së pari vendos nëse janë të justifikuara – nuk është e pazakontë që përdoruesit e mediave ta ekzagjerojnë apo të bëjnë gabime. Ombudsmani ka kodin e vet të etikës, por idealisht do t'i gjykojë ankesat përkundrejt një kodi etike të brendshëm të paracaktuar. Nëse ky kod nuk ekziston, ai mund të sugjerojë që të krijohet. Do të merren si referencë edhe kodet e etikës profesionale.

#### *Çfarë masash sanksionuese mund të merren?*

Botimi — i fragmenteve të letrave, korrigjimeve dhe mbi të gjitha i rubrikës së ombudsmanit, ku botohen mangësitë dhe gabimet — është një masë shumë e fuqishme. Mund të vendosen sanksione morale me ashpërsi të ndryshme. Një ombudsman mund të:

- Përcjellë korrespondencën dhe t'i kërkojë autorit të artikullit që të përgjigjet (“dënim” minimal);
- Kërkojë, përveç kësaj, që gazeta të botojë një korrigjim (normal);
- Botojë një fragment nga letra e lexuesit (i ashpër);
- Diskutojë gabimin në rubrikën e ombudsmanit (ekstrem): kjo masë duhet ruajtur për rastet më të rënda, pasi gazetarët e konsiderojnë si një qortim publik dhe turpërim.

#### *Si i zgjedhin ombudsmanët sanksionet më të përshtatshme?*

Nëse duan të jenë efektivë dhe të mbajnë marrëdhënie të mira me stafin, ombudsmanët nuk duhet të vendosin sanksione në të gjitha rastet dhe duhet të shmangin masat që zemërojnë seriozisht gazetarët apo që dëmtojnë reputacionin e tyre. Ata duhet të jenë të matur dhe të shmangin padrejtësitë ose ekseset. Shpesh nuk ka vlerë që të përmenden emra pasi personat e përfshirë – dhe kolegët e tyre – tashmë e dinë se cilët janë ata.

Është më e rëndësishme dhe konstruktive që të kuptohet pse bëhen gabime. Shpesh është e pamundur të zbulohen shkaqet e padukshme të një natyre më të përgjithshme. Mund të ketë periudha, për shembull, kur një kopje qarkullohet jo si duhet për shkak të trysnisë së prodhimit ose problemeve të personelit, kështu që disa artikuj nuk redaktohen si duhet ose fare. Në kësi rastesh, ombudsmani mund të sugjerojë me takt një zgjidhje, duke u siguruar që të mos shkelë kompetencat e të tjerëve në hierarki. Ombudsmanët nuk janë as gjykatës e as punonjës policie. Në rastin më të mirë, ata janë ndërgjegjja e grupit.

## 4. Krijimi i pozicionit të Ombudsmanit

### *Kush vendos për krijimin e Ombudsmanit?*

Strukturat drejtuese në rastin e medias private dhe bordi i guvernatorëve në rastin e medias publike.

### *Si mund të nxitet një organ i medias të krijojë pozicionin e Ombudsmanit?*

Në shumicën e rasteve, pozicioni i Ombudsmanit krijohet pas një krize mes lexuesve, kur një organ i medias duhet të rivendosë urgjentisht lidhjet me ta. Kështu ka ndodhur me *New York Times*, e cila caktoi një ombudsman në tetor 2003 pasi u trondit nga zbulimi se një prej gazetarëve të saj ishte fajtor për plagjiaturë dhe sajim lajmesh.

### *Çfarë argumentesh mund t'i bindin pronarët e mediave për vlerat e një Ombudsmani?*

Ombudsmanët, përveçse janë “në modë” (shumica e gazetave kryesore në botë e kanë një të tillë), përbëjnë një tregues të rëndësishëm për lexuesit dhe nxisin komunikimin me të. Ai përmirëson cilësinë e informacionit, stilin dhe redaktimin e tij. Parandalon katastrofa madhore: një ombudsman që gëzon marrëdhënie të mira me drejtorin e redaksisë mund të kryejë funksionin e një pararoje. Përfundimisht, nëse ombudsmani shkruan mirë, rubrika e tij do të jetë popullore dhe do të lexohet gjerësisht. Publiku është shumë i interesuar të mësojë se si mbliidhet informacioni dhe se çfarë ndodh në prapaskenë.

### ***Çfarë hapash duhet të merren për të krijuar pozicionin e ombudsmanit?***

Faza e parë mund të jetë krijimi i një departamenti për korrespondencën me përdoruesit e medias për të marrë mesazhe (me postë, e-mail ose telefon), për t'i përpunuar ato, për t'u kthyer përgjigje, për t'u përcjellë komente njerëzve të interesuar, dhe, nëse është e nevojshme, për të botuar pjesë të këtyre mesazheve. Mund të krijohet edhe një shërbim në internet.

Pastaj të gjitha palët e organit të medias duhet të bien dakord mbi një statut, që do të shërbejë si bazë për një lloj kontrate të nënkuptuar me përdoruesit. Për shembull, statuti i *Le Monde*, thotë se informacioni duhet të jepet në mënyrën më të saktë, më të plotë dhe më të qartë të mundshme; duhet të ketë një dallim të qartë midis informacionit dhe komenteve; gabimet duhet të korrigjohen; sgazeta duhet të pasqyrojë pluralizmin dhe larminë e opinionëve; dhe të drejtat e individëve dhe privacia e tyre duhen respektuar.

Pastaj duhet përzgjedhur një ombudsman dhe kjo nismë i duhet bërë e njohur lexuesve.

## 5. Përzgjedhja e ombudsmanit

### *A duhet të jetë ombudsmani gazetar?*

Po. Vetëm një profesionist mund të vlerësojë siç duhet gabimet dhe pasaktësitë e bëra dhe vështirësitë e punës në të njëjtën kohë. Përdoruesit e medias shpesh janë shumë të ashpër dhe nuk i kuptojnë kushtet në të cilat punojnë gazetarët dhe vështirësitë që hasin ata, si kufizimet kohore, vështirësitë për t'u takuar me burimet e informacionit dhe stresi i përgjithshëm. Një pjesë e punës së ombudsmanit është edhe t'ua shpjegojë këtë lexuesve, të cilët e vlerësojnë shumë informimin rreth prodhimit të gazetave.

Në të njëjtën kohë, gazetarët nuk e kuptojnë se sa shumë tronditen lexuesit dhe se sa shumë shkatërrohet besueshmëria e gazetës nga gabimet e tyre (ekzagjerime, tituj të njëanshëm, gabimet gramatikore dhe ato të drejtshkrimit, etj.). Ata nuk i mirëpresin dhe aq mirë kritikën. Edhe kur kritika vjen nga një koleg, ajo është mjaft e vështirë për t'u pranuar; kur vjen nga një i jashtëm do të ishte e pamundur për t'u pranuar.

### *Cilat janë kriteret për emërimin e një ombudsmani?*

Personi duhet të ketë përvojë, të njohë mirë procesin e redaktimit, të njihet për aftësinë e tij profesionale, dhe, mbi të gjitha, të jetë i paanshëm. Kriteri kryesor duhet të jetë pavarësia e frymës së tyre, që nuk është diçka e lehtë për t'u matur, por mund të identifikohet duke shqyrtuar formimin dhe karrierën e kandidatëve. Ombudsmani duhet të shfaqë edhe një masë të caktuar diplomacie, e cila mund edhe të dallohet në një periudhë afatgjatë. Edhe një lloj qasjeje autoritare nuk do të ishte e dëmshme.

Ombudsmani nuk duhet të jetë tepër i lidhur me asnjë klikë gazetarësh (të tilla ka gjithmonë), sindikatë, parti politike apo nivel drejtues, dhe duhet të pranohet nga rrymat e ndryshme të opinioneve brenda një media.

### ***Kush e zgjedh ombudsmenin?***

Zakonisht niveli drejtues, mundësisht duke u konsultuar edhe me stafin editorial. Më e mira është që kandidati i përzgjedhur t'i dërgohet shoqatës së gazetarëve, nëse ekziston një e tillë. Në disa gazeta, ombudsmeni zgjidhet për një periudhë të caktuar kohe, që i siguron atij popullaritet nga njëra anë, por e bën të dyshueshëm në sytë e nivelit drejtues nga ana tjetër.

### ***Çfarë mund të bëhet që ombudsmeni të pranohet nga stafi editorial?***

Stafi editorial dhe drejtuesit e gazetës duhet të kenë një kod të njohur dhe të përbashkët sjelljeje dhe duhet të ekzistojë një lloj konsensusi mbi qëllimin e gazetës dhe kontratës së saj të nënkuptuar me lexuesit. Informacioni duhet të qarkullojë siç duhet brenda organizatës dhe duhet të ekzistojë edhe mundësia për kritikë të brendshme dhe liri shprehjeje.

### ***Sa të ndjeshëm janë gazetarët ndaj kritikave të një ombudsmeni?***

Tepër të ndjeshëm. Gazetarët nuk i preferojnë shumë njerëzit që fusin hundët në punët e tyre dhe nuk para i presin mirë kritikën. Reagimi i tyre klasik është: “Pse po ndërhysh ombudsmeni? Kjo nuk është puna e tij.” Ombudsmeni duhet të tregohet shumë i kujdesshëm që të jetë i paanshëm në mënyrë që gazetarët të mos e konsiderojnë si një koleg të pabesë që vepron si “polic” (apo, më keq akoma, si një spiun) i nivelit drejtues.

### ***Sa është rroga mesatare e një ombudsmeni?***

Sa rroga e një shefi departamenti apo kryeredaktori, ndonjëherë edhe më e lartë. Përgjithësisht është mjaft e lartë, sepse ombudsmenët janë zakonisht gazetarë të njohur, të cilët vlerësohen nga kolegët e tyre dhe kanë mbajtur edhe më përpara pozicione me përgjegjësi.

***Kush duhet ta paguajë ombudsmanin?***

Vetë organi i medias, duke u ndihmuar ndoshta edhe nga përjashtimi i kësaj pagese nga taksimi.



## 6. Sfidat e pozicionit të ombudsmanit

### *Si mund të garantohet pavarësia e ombudsmanit?*

Ombudsmani duhet të emërohet për një periudhë minimalisht dyvjeçare, të ketë rregullisht një hapësirë për të shprehur opinionet e tij në një rubrikë apo program që nuk është objekt i kontrollit hierarkik, dhe të ketë kontakt të drejtpërdrejtë me lexuesit.

Hapësira e pavarur për opinionet e ombudsmanit është shumë e rëndësishme. Në gazetën *Le Monde* kjo është e vetmja kopje që nuk redaktohet si zakonisht. Kjo rubrikë i jep mundësi ombudsmanit t'i drejtohet lexuesve, gazetarëve dhe, nëse është e nevojshme, edhe nivelit drejtues të organit të medias. Ajo është tejte delikate dhe zgjedhja e temës që trajton është gjëja më e vështirë.

Mbrojtja kryesore e ombudsmanëve është vetë popullariteti i tyre. Në gazetën *Le Monde* një kryeredaktor u përpoq një herë ta ndryshonte ombudsmanin, por plani i tij u përmbys nga indinjata që shkaktoi kjo gjë mes stafit të tij. Është mjaft e vështirë për drejtuesit e një gazete që të vendosin ta shkrijnë postin e ombudsmanit apo të ndryshojnë personin që e mban atë, për shkak se kjo gjë do të kishte pasoja shkatërruese për imazhin e gazetës.

Disa gazeta amerikane i kanë shkrirë postet e ombudsmanëve kohët e fundit si një masë për të ulur kostot. Rreziku qëndron tek emërimi në vend të tij i një "komunikuesi", dhe i shndërrimit të këtij pozicioni në një zëdhënës të nivelit drejtues. Lexuesit nuk gënjejnë nga kjo, ashtu sikurse nuk gënjejnë as stafi editorial: ky zëvendësim në rastin më të mirë bëhet joefektiv dhe në

rastin më të keq një objekt përcmimi.

### ***A besojnë lexuesit tek pavarësia e ombudsmanit dhe tek ndikimi i tij te gazetarët?***

Shumëkush dyshon nëse kjo qëndron. Ata nuk e kuptojnë dot se ekzistenca e Ombudsmanit dhe kërcënimi i kritikës në rubrikën e ombudsmanit është një mekanizëm shumë i fuqishëm vetërregullues. Ata harrojnë se kjo rubrikë lexohet brendapërbrenda. Ata do të donin që ombudsmani t'u mbante anën çdo javë dhe t'i kritikonte gazetarët mbarë e prapë. Kjo është arsyeja përse është e rëndësishme që me ta të mbahen lidhje të drejtpërdrejta për të justifikuar dhe për të shpjeguar rolin e ombudsmanit.

Në të njëjtën kohë lexuesit gëzohen shumë kur marrin përgjigje për pyetjet që bëjnë dhe kur u përmendet emri në rubrikën e ombudsmanit.

“Ujqit” bëhen “qingja”. Është e mahnitshme të shohësh se sa lehtë dhe sa shpejt mund të krijohen lidhje me lexuesit thjesht duke iu përgjigjur një pyetjeje që ata mund të bëjnë.

### ***Çfarë hapësire manovrimi ka një ombudsman?***

Shumë pak. Duhet gjetur vazhdimisht një lloj kompromisi midis përfaqësimit të shqetësimeve legjitime të lexuesve (dhe cilësisë së gazetës) dhe ruajtjes së kontaktit me gazetarët (provë e efektshmërisë së tij).

Gjithçka varet nga aftësia e ombudsmanit për të pasur një marrëdhënie besimi dhe jo armiqësie si me gazetarët, ashtu edhe me nivelin drejtues të gazetës. Ombudsmani nuk duhet të jetë tepër i afërt as me njërin palë as me tjetrën, por nuk duhet të jetë në të njëjtën kohë as armiku i tyre i deklaruar. Nëse janë shumë afër, ata do të trajtohen si agjentë të marrëdhënive me publikun dhe do të jenë pa vlerë: lexuesit do të zhgënjehen dhe nuk do t'i lexojnë pikëpamjet e tyre. Nëse janë tepër armiqësorë, ata nuk do të jenë në gjendje të bëjnë një dialog konstruktiv: lexuesit do të jenë të lumtur, por

gazetarët nuk do t'ua vënë më veshin. Ruajtja e kësaj distance të rëndësishme është sfida më e madhe, me të cilën duhet të përballet një ombudsman.

### ***L'Hebdo du Médiateur: një shembull transmetimi***

Nga Jean-Claude Allanic (Ombudsman i kanalit France 2 për Informacionin, 2000-2005)

Programi *L'Hebdo du Médiateur* ("Java e ndërmjetësuesit") u transmetua për herë të parë në vitin 1998 në kanalën televizive franceze France 2 pas emërimit të ombudsmanit të tij të parë të informacionit. Në këtë program 20-minutësh, i cili transmetohet të shtunave fill pas lajmeve të orës 13:00, gazetarëve u kërkohet t'u përgjigjen kritikave, komenteve dhe pyetjeve të teleshikuesve.

Prezantuar nga ombudsmani dhe bazuar tek letrat e marra javët e mëparshme, ky program rishikon buletinet dhe revistat e ndryshme të lajmeve. Ai jep informacion, bën saktësime, dhe kur është e nevojshme, shpjegon kushtet në të cilat kanë qenë përgatitur raportet, sqaron lajmet e keqkuptuara dhe komentet e keqinterpretuara, pranon gabimet dhe kërkon ndjesë – dhe kjo nuk është e lehtë!

Zakonisht ftohen në studio dy-tre teleshikues, ose merren komentet e tyre me telefon ose faks nga shtëpia. Lexohen pjesë letrash apo emailash nga teleshikuesit. Gazetarët japin përgjigje dhe diskutojnë me të ftuarit, duke u përfshirë ndonjëherë edhe në debate mjaft të nxehta. Në studio mund të ftohen edhe specialistë për të dhënë mendimin e tyre mbi çështjet që diskutohen aty, (për shembull çështje mbi ekonominë, shkencën, fenë).

Ombudsmani duhet të mbetet sa më neutral që të jetë e mundur. Megjithatë, ai ose ajo mund të bëjë një përmbledhje të përgjithshme në fund të programit, të rikujtojë rregullat bazë të gazetarisë, apo të japë opinionin e tij, si dhe të bëjë sugjerime për të ardhmen, bazuar në kodin profesional të etikës dhe statutin e transmetimit të televizioneve franceze, grupi i televizionit publik, të cilit i përket kanali France 2

Disa nga temat e trajtuara në program janë të pritura të ripërsëriten: dhuna në ekran, rreptësia (ose mungesa e saj) në paraqitjen e fakteve, përfrimin gazetaresk, përparësia e lajmeve, mbrojtja e privacisë dhe respekti për individin, mungesa e respektit për pluralizmin dhe neutralitetin politik. Temat e tjera varen nga lajmet: konflikti në Lindjen e Mesme, zgjedhjet, temat kryesore ekonomike, problemet sociale, fatkeqësitë, diskutimet shkencore, ngjarjet sportive dhe kulturore. Me fjalë të tjera, programi trajton çështjet më të rëndësishme të ditës nga një këndvështrim i veçantë dhe origjinal, domethënë nga qëndrimi kritik i publikut ndaj punës së gazetarëve.

Suksesi i *L'Hebdo du Médiateur* dhe besimi i shfaqur tek ai nga teleshikuesit vjen para së gjithash nga statusi i veçantë i ombudsmanit – pavarësi e plotë nga niveli drejtues dhe nga orientimet dhe hierarkia editoriale. Ombudsmani vendos vetë se kush ftohet të marrë pjesë. Ky program është i vetmi që nuk monitorohet para transmetimit. Parimi i mekanizmit të ombudsmanit dhe kohëzgjatja e mandatit të tij parandalojnë çdo përpjekje për të ushtruar presion mbi të, ose për t'i ndërhyrë në punën e tij.

Në këmbim të kësaj pavarësie. Ombudsmani pritet të garantojë një dialog të ndershëm dhe të ekuilibruar, i cili i lejon si teleshikuesit, ashtu edhe gazetarët të shprehen lirshëm dhe në mënyrë konstruktive. Janë dy kurthe që ombudsmani duhet t'i shmangë. Programi nuk duhet parë si një mundësi për të shfajësuar çdo javë gazetarët për gabimet e tyre. Nga ana tjetër, nuk duhet të jetë dhe aq i ashpër, saqë gazetarët ta marrin si një sulm nga teleshikuesit, apo si një ndëshkim për cilësinë e punës së tyre. Ombudsmani duhet të fitojë dhe të ruajë si besimin e publikut, ashtu edhe të kolegëve të tij.





# Shtojcë

## Shembuj ankesash të zgjidhura nga organet vetërregulluese

Zgjidhja e ankesave është detyra thelbësore e një organi vetërregullues, që përpiket të garantojë respektimin e kodit të tij të etikës. Ai shmang procedurat e gjata dhe të kushtueshme gjyqësore dhe megjithëse ky organ jep vetëm sanksione morale, e drejta për të dhënë një përgjigje apo për të bërë një korigjim shpesh mjafton për të kënaqur ankuesit. Shumica e organeve vetërregulluese përpiqen të arrijnë një marrëveshje midis palëve para se se të japin gjykimin e tyre.

Kjo shtojcë jep shembuj ankesash dhe gjykimesh të dhëna nga organe vetërregulluese. Secili rast është gjykuar sipas kodit të etikës së vendit ku është paraqitur rasti, kështu që rezultatet gjetkë mund të kishin qenë, sigurisht, të ndryshme. Megjithatë, këto shembuj na japin një ide se sa efektive mund të jenë këshillat e medias në zëvendësimin e gjykatave dhe në arritjen e zgjidhjeve pa ndërhyrjen e gjyqësorit.

Shumica e ankesave që trajtohen nga këshillat e medias së shkruar kanë të bëjnë me pasaktësi apo cënimin e privacisë.





## Rasti 1: Ankesë për cenimin e privacisë

Babai i një gruaje të zhdukur në tragjedinë e cunamit aziatik iu ankua *Presserat*it (Këshillit Gjerman të Medias së Shkruar) se një gazetë tabloide kishte publikuar emrin dhe fotografinë e saj. Ishte një nga disa fotografi të tilla të viktimës të marra nga një faqe interneti e cila ishte krijuar për të gjetur njerëzit e humbur. Babai u ankua se gazeta kishte shkelur të drejtën personale të familjes për privaci.

### **Rezultati:**

Ankesa u pranua. Komisioni i ankesave i *Presserat*-it, u shpreh se qëndrojti i interesit publik nuk mund të detyrojë drejtë individëve të përfshirë. Viktimat e një tragjedie të tillë si cunami, nuk u bënë automatikisht figura publike.

Fakti që informacioni ishte publikuar në faqe interneti që kishin për qëllim kërkimin e njerëzve të humbur, nuk ishte arsye e mjaftueshme që gazeta ta ribotonte atë pa pëlqimin e familjes.

## Rasti 2: Ankesë për cenimin e privacisë

Në Këshillin e Shtypit të Bosnjë Hercegovinës, pati një diskutim rreth një artikulli të botuar në të përditshmen *Dnevni Avaz* për një aksident rrugor. Ankuesi nuk kishte kundërshti për vetë artikullin, por tha se fotografitë e viktimave ishin shkelje e privacisë dhe nuk duhet të ishin botuar.

### **Rezultati:**

Ankesa u pranua. Këshilli i shtypit u shpreh se të tilla ngjarje ishin diskutuar edhe më parë nga ky këshill dhe në disa raste këshilli u kishte kujtuar redaktorëve se lexuesit mund ta kundërshtojnë botimin e fotografive të tilla. Në këtë rast, *Dnevni Avaz* kishte shkelur nenin 9 të Kodit të Shtypit, në të cilin thuhet: “Trajtimi i historive që kanë të bëjnë me tragjedi personale do të bëhet me kujdes dhe personat e prekur do të kontaktohen me dhembshuri dhe diskrecion”.

Këshilli i shtypit e përsëriti edhe një herë pikëpamjen e tij se botimi i fotografive nga skenat e aksidenteve, i emrave të të miturve viktimave të dhunës apo viktimave të ngacmimit seksual, nuk ishte në përputhje me raportimin profesional gazetaresk.

## Rasti 3: Ankesë për pasaktësi

Drejtori i një librarie islamike u ankua tek Komisioni i Ankesave ndaj Shtypit të Britanisë së Madhe se një artikull i *London Evening Standard*, me titull “Terrori dhe urrejtja shiten vetëm pak metra nga rruga Baker”, ishte i pasaktë, keqinformues dhe shkelte kaluzolën për saktësinë në Kodin e Praktikës Editoriale.

Artikulli bënte fjalë për literaturë ekstremiste që pretendohet se shitej në libraritë islamiste pas bombardimeve në Londër. Libraria e ankuesit ishte paraqitur dukshëm në një fotografi sëbashku me tre tituj për të cilët gazeta thoshte se mbronin terrorizmin dhe pretendonte se shiteshin në ambiente “të tilla si Dar Al-Taqwa”. Ankuesi tha se dyqani nuk kishte pasur asnjëherë librat apo DVD-të e paraqitura në fotografi. Artikulli ishte keqinformues dhe i bënte njerëzit të besonin se dyqani inkurajonte dhe nxiste terrorizmin.

Gazeta kishte cituar pjesë të përzgjedhura nga një pamflet mbi xhihadin i cili shitej në librarë. Ankuesi tha se ky pamflet nuk nxiste terror apo urrejtje siç pretendohet në artikull. Si rezultat i këtij botimi, dyqani ishte bërë pré e abuzimeve dhe kërcënimeve të dhunshme të cilat kishin kërkuar mbrojtjen e policisë.

### **Rezultati:**

Ankesa u pranua. Komisioni i Ankesave ndaj Shtypit u shpreh se në nenin 1 të kodit të tij të praktikës u kërkohet gazetave “të jenë të kujdesshme e të mos botojnë informacion që është i pasaktë, keqinformues apo i shtrëmbëruar”. Në këtë rast – duke marrë parasysh rëndësinë e akuzave dhe momentin delikat në të cilin u botuan, pak pas sulmeve terroriste – ishte shumë e rëndësishme të sigurohej se informacioni i mbledhur nga gazeta të paraqitej saktë.

Megjithëse nuk pati diskutim që libreria e shiste pamfletin e cituar,

përmbajta e tij nuk i mbështeste pretendimet e ekzagjeruara në titull. Pra, gazeta nuk ishte kujdesur mjaftueshëm për ta paraqitur saktë historinë.

Komisioni i Ankesave ndaj Shtypit, u shpreh gjithashtu se në një klimë ankthi pas sulmeve, pasojat e pretendimeve çorientuese mund të kishin qenë tejet të rënda për ankuesin – sidomos pasi të dhënat e kontaktimit të dyqanit ishin paraqitur mjaft dukshëm.

## Rasti 4: Ankesë për pasaktësi në një faqe interneti

Këshilli i Gazetarisë në Flander/Belgjikë mori një ankesë rreth një artikulli të marrë nga arkiva e një gazete në internet.

Në vitin 2005, gazeta kishte publikuar një artikull ku thuhej se ankuesi ishte akuzuar për ngacmim seksual. Ky informacion ishte i pasaktë dhe gazeta nxorri një korrigjim në botimin e saj të rradhës. Megjithatë, në vitin 2007 artikulli ishte ende i disponueshëm në faqen e internetit ku mund të lexoheshin të gjitha botimet e mëparshme dhe mund të shkarkoheshin lehtësisht duke përdorur një mjet kërkimi në internet, si për shembull *Google*. Ankuesi tha se për këtë arsye ai nuk e fitoi punën për të cilën kishte aplikuar.

### **Rezultati:**

Ombudsmani i këshillit ia referon çështjet këshillit vetëm nëse nuk arrihet një marrëveshje miqësore. Në këtë rast, midis ankuesit dhe gazetës nuk u arrit një marrëveshje e tillë.

Gazeta ishte e ndërgjegjshme për gabimin e rëndë që përmbante artikulli, por nuk mund të ndryshonte tekstin origjinal që në një farë mënyre do të thoshte falsifikim i fakteve historike. Gjithësesi, gazeta ishte gjithashtu e ndërgjegjshme se artikulli mund të ishte i dëmshëm për ankuesin dhe ishte e gatshme të gjente një zgjidhje. Ankuesi e kuptoi se artikulli origjinal nuk mund të ndryshohej por donte një sqarim të menjëhershëm që artikulli përmbante një gabim të rëndë. Marrëveshja përfundimtare ishte që në artikullin origjinal në faqen e internetit të vihej dukshëm dhe qartë një adresë lidhëse e cila të drejtonte tek korrigjimi i artikullit, në mënyrë që lexuesit e artikullit origjinal të shihnin menjëherë që kishte një korrigjim. Ankuesi ishte i kënaqur me këtë zgjidhje dhe e tërhoqi ankesën.

## Rasti 5: Ankesë për mosmbrojtjen e personave vulnerabël

Këshilli i Shtypit në Bosnjë Hercegovinë mori një ankesë për një artikull të gazetës *Dnevni List* të titulluar “Nxënësja e shkollës së mesme në ferrin e prostitucionit”, në të cilin përmendej emri i një vajze të mitur për të cilën pretendohet se ishte e përfshirë në prostitucion.

### **Rezultati:**

Ankesa u pranua. Këshilli i shtypit vendosi që gazeta kishte shkelur nenin 11 të kodit të shtypit në të cilin trajtohet mbrojtja e fëmijëve dhe të miturve.

Megjithëse e ëma e vajzës së mitur i kishte dhënë gazetës informacion për të, gazeta ishte e detyruar të mbronte identitetin e saj. Kjo kishte një rëndësi të veçantë në këtë rast ku historia bazohej në dyshimet e së ëmës, të cilat nuk ishin konfirmuar nga policia, prokuroria apo gjykata.

Këshilli i shtypit rekomandoi që vendimi të botohej në numrin e radhës të gazetës.

## Rasti 6: Ankesë për mosmbrojtjen e personave vulnerabël

Policia e luginës së Tamizit (*Thames Valley Police*) u ankua në Komisionin e Ankesave ndaj Shtypit në Britaninë e Madhe në emër të një viktime përdhunimi të paemër për një artikull të botuar në gazetën *London Metro* me titull “Përdhunuesi i pret flokët gruas me kancer”. Në artikull raportohej për përdhunimin e një gruaje të re, jepej emri i qytetit ku kishte ndodhur përdhunimi si dhe hollësi mbi ngjarjen. Në artikull jepej gjithashtu informacion për viktimën, moshën e saj, problemet shëndetësore dhe detaje të “shtëpisë së banimit” ku kishte ndodhur ngjarja.

Policia pretendonte se artikulli përmbante detaje të tepërta që kishin të ngjarë të çonin në identifikimin e viktimës apo të paktën të hidhnin dritë mbi identitetin e saj, duke shkelur kështu nenin 12 të kodit të praktikës ku trajtoheshin viktimat e përdhunimit seksual.

Gazeta theksoi se nuk e kishte përmendur me emër zonën e banimit ku kishte ndodhur përdhunimi dhe në histori nuk dilte qartë nëse viktima jetonte në atë zonë e madje në të njëjtin qytet, apo jo.

### **Rezultati:**

Ankesa u pranua. Komisioni i Ankesave ndaj Shtypit u shpreh se për një sërë arsyesh, e sidomos për vulnerabilitetin e madh të viktimave të krimeve kaq tronditëse, kodi i praktikës ua ngarkonte përgjegjësinë botuesëve. Kodi jo vetëm që ndalonte identifikimin por edhe çfarëdolloj informacioni që ka të ngjarë të çojë në identifikim. Kjo pjesë e kodit nuk kishte të bënte me mbrojtjen e interesit publik më shumë se sa me rëndësinë që kishte ndjekja me rigorozitet dhe përpikëri e kushteve të kodit nga të gjithë botuesit.



Në këtë rast, në artikull nuk ishte dhënë emri i viktimës apo adresa e saj, por kishte informacion të mjaftueshëm i cili mund të çonte në identifikim dhe për këtë arsye kodi ishte shkelur.

Komisioni u shpreh se ishte jashtëzakonisht e rëndësishme që raportimet mbi veprat penale seksuale të hartoheshin në mënyrë sa më të ndërgjegjshme. Çdo hollësi tjetër përveç atyre bazë, e madhe apo e vogël qoftë, mund ta bëjë viktimën të identifikueshme për dikë që nuk ka dijeni për krimin. Kodi ka për qëllim të sigurojë që një gjë e tillë të mos ndodhë dhe viktimat të ruajnë anonimitetin e merituar. Komisioni vuri në dukje që shkelje të këtij neni ishin mjaft të rralla falë standardeve në përgjithësi të larta të raportimit.

## Rasti 7: Ankesë për diskriminim

Këshilli zviceran i shtypit mori një ankesë në lidhje me një karikaturë të Chappatte-së të botuar në të përditshmen *Le Temps*. Në të paraqitej i ndjeri Papa Gjon Pali II nën një kryq, pas të cilit një turmë besimtarësh, disa prej të cilëve me aparate fotografikë, po meditonin. Jezusi i kryqëzuar i pyet: “A ju shqetësoj unë me ekzistencën time?”

Ankuesi tha se karikatura fyente të krishterët dhe njerëzit e kulturuar dhe se botimi i saj shkelte nenin e kodit të gazetarëve për diskriminimin. Nëse do të ishin sulmuar në këtë mënyrë hebrenjtë apo myslimanët, do të ishte depozituar një padi për racizëm në gjykatë.

### **Rezultati:**

Ankesa nuk u pranua. Këshilli zviceran i shtypit u shpreh se satira dhe karikaturat mbi temat fetare ishin përgjithësisht të pranueshme. Kjo liri nuk kufizohej nga fakti që disa besime e ndalonin paraqitjen me figurë të disa objekteve apo personave dhe nuk kishte përse të merrte parasysh ndjeshmërinë e disa qarqeve konvencionale. Kjo liri duhet ushtruar proporcionalisht në një frymë demokratike.

Në këtë rast kufizimet e lirisë për të komentuar nuk ishin tejkaluar sipas pikëpamjes së publikut të gjerë dhe interesit të medias në vdekjen e Papës. Arsyetimi mbi të cilin qëndronin karikaturat dhe baza faktike e tij njiheshin nga publiku.



# Biografi



## Autorët

### *Yavuz Baydar*

Pasi futi konceptin e ombudsmanit tek shtypi dhe lexuesi turk, Yavuz Baydar ka shtatë vjet tashmë që shërben si ombudsman dhe boton rubrikën e tij çdo të hënë në të përditshmën *Sabah*. Emërimi i tij i parë si ombudsman ishte në vitin 1999 për *Milliyet*. Yavuz Baydar është gjithashtu një anëtar aktiv i Organizatës së Ombudsmenëve të Lajmeve (ONO). Atje ka shërbyer si zyrtar, zëvendës-president dhe ka qenë presidenti i parë jo amerikan-verior për vitin 2003 dhe vitin 2004. Përpara se të bëhej ombudsman, Baydar ka punuar si reporter, korrespondent i huaj dhe botues për media të ndryshme.

### *William Gore*

William Gore hyri në Komisionin e Ankesave ndaj Shtypit në vitin 2000 si nënpunës i ankesave, pasi u diplomua në universitetin Oksford ku studioi historinë e kohës së sotme. Pas dymbëdhjetë muajsh shërbim, ai hyri në projektet ndërkombëtare të komisionit ku ndër të tjera punoi edhe për ngritjen e një këshilli të ri shtypi në për Bosnjë Hercegovinën. Në mars të vitit 2004 William Gore u emërua zëvendës-drejtor i Komisionit të Ankesave ndaj Shtypit. Ai vazhdon ta ruajë rolin e tij në çështjet ndërkombëtare dhe në punën e përditshme me ankesat, por tashmë ka më tepër përgjegjësi në punën e përgjithshme të komisionit të ankesave.

### *Miklós Haraszti*

Shkrimtar, gazetar, avokat hungarez për të drejtat e njeriut dhe profesor në universitet, Miklós Haraszti është emëruar Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Mediave në 10 mars të vitit 2004. Z. Haraszti ka studiuar filozofi

dhe letërsi në Universitetin e Budapestit. Në vitin 1976, ai bashkëthemeloi Lëvizjen Demokratike Opozitare Hungareze dhe në vitin 1980 u bë redaktor në gazetën samizdate *Beszélo*. Në 1989, Haraszti mori pjesë në nogaciatat “në tryezë të rrumbullakët” për tranzicionin në zgjedhje të lira. Pas mandatit të tij si deputet në parlamentin hungarez gjatë viteve 1990-1994, ai filloi të jepte leksione mbi demokratizimin dhe politikën e medias në shumë universitete. Ndër librat e z. Haraszti renditen: “Një punëtor në shtetin e punëtorëve” (“*A Worker in a Worker’s State*”) dhe “Burgu i kadiftë” (“*The Velvet Prison*”), të cilët janë botuar në disa gjuhë.

### **Véronique Maurus**

Véronique Maurus ka qenë ombudsmene për të përditshmen franceze *Le Monde* që nga viti 2006. Pasi kreu studimet për anglisht dhe ekonomik, Véronique Maurus hyri në ekipin e redaktorëve të *Le Monde* kur ishte 22 vjeç dhe karrierën e saj e ka ndërtuar pikërisht aty. Filloi punë në seksionin e ekonomisë së gazetës dhe në vitin 1995 arriti statusin e reporterës së rëndësishme dhe u bë zëvendësdrejtore e seksionit të raporteve. Ajo është gjithashtu edhe autore e dy librave: “*Voyage au pays des mythes*” (“*Udhëtim në vendet e miteve*”) dhe “*La vie secrète du Louvre*” (“*Jeta sekrete e Luvrit*”).

### **Ognian Zlatev**

Ognian Zlatev është drejtori i përgjithshëm i Qendrës së Zhvillimit të Medias në Bullgari. Kjo organizatë është krijuar në vitin 1998 për të inkurajuar zhvillimin e medias së pavarur në Bullgari, për të nxitur rritjen e kapacitetit të mediave dhe për të rritur rrjetëzimin dhe bashkëpunimin ndërkufitar në Evropën Juglindore. Ognian Zlatev është gjithashtu anëtar bordi i Këshillit Kombëtar të Etikës së Gazetarisë në Bullgari, anëtar themelues i Rrjetit të Evropës Juglindore për Profesionalizimin e Medias (SEENPM), dhe anëtar i Bordit të Organizatës së Medias për Evropën Juglindore (SEEMO), e lidhur me Institutin Ndërkombëtar të Shtypit në Vjenë.

## Botuesit

### *Adeline Hulin*

Adeline Hulin ka qenë zëvendës oficere projekti e zyrës së OSBE-së për lirinë e mediave që nga viti 2006. Përpara kësaj detyre ajo ka punuar si këshilltare për Qendrën Franceze të Ndërlidhjes së Medias dhe Arsimit (CLEMI) dhe për UNESCO-n ku është marrë me programet edukative të medias. Adeline Hulin ka kryer master në gazetari në universitetin Paris Dauphine dhe është diplomuar për shkenca politike në Insitutin e Bordosë për Studime Politike.

### *Jon Smith*

Jon Smith ka punuar si gazetar për një sërë gazetash britanike ku ndër të tjera edhe për *The Times*, përpara se të bëhej lektor madhor në kolegjin Darlington në Angli, i specializuar në të drejtën dhe etikën e medias. Ai është pedagog kontrollues në Këshillin Kombëtar të Britanisë së Madhe për Trajnimin e Gazetarëve dhe autor i teksit të hyrjes në gazetari, të rekomanduar nga ky këshill “Essential Reporting” (“*Bazat e Raportimit*”).











[www.osce.org/fom](http://www.osce.org/fom)

PËRFAQËSUESI PËR LIRINË E MEDIAS

Organizata për Sigurim dhe  
Bashkëpunim në Evropë

ISBN 3-9501995-7-2



